



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE”**

Tiranë Shtator 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	6
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	7
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Siguria e informacionit	8-17
1	Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.	
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	18-38
1	Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit	
2.3	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output	39-50
IV.	REKOMANDIME	51-63

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, nga data 22.04.2024 deri në 10.07.2024.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në AKBN, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar në drejtim të Lejeve Minerare në AKBN, si dhe në rastet kur vetë institucioni ka qenë përfitues shërbimi për kontrata që janë lidhur nga AKSHI. Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 477/1, me datë 19.04.2024.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se AKBN nuk disponon Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një plan strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit. Gjithashtu, konstatohet se ndërgjegjshmëria në nivel institucional është e ulët për shkak se nuk janë zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për të gjithë punonjësit.

- AKBN nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013.

- Nga auditimi i kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site-Disaster Recovery Site”, u konstatua se:

- Vlera e kontratës 52,650,000 lekë (pa TVSH) është 24% më e lartë se fondi që AKBN ka përlllogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020 në MIE e cila është 40,000,000 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit nuk ka administruar asnjë dokumentacion ndërmjet AKBN dhe AKSHI-it në lidhje me ndryshimin e përlllogaritjes së fondit limit me fondin që AKBN ka përlllogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020, si dhe nuk është marrë dakordësia nga AKBN për rritjen e fondit limit në vlerën 12,650,000 lekë.

- Nga auditimi konstatohet se AKBN nuk administronte asnjë dokumentacion në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e vlerës limit dhe hartimin e termave të referencës, për të cilën janë ngritur dhe urdhrat respektiv nga AKBN dhe AKSHI. Dokumentacioni i këtyre shkresave i është vendosur në dispozicion AKBN-ës pas 4 vitesh nga AKSHI, pasi është kërkuar nga grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit nëpërmjet komunikimeve me email dhe shkresave zyrtare drejtuar AKSHI-it nga AKBN.

- AKBN dhe AKSHI nuk kanë dakordësuar me një shkresë zyrtare për hostimin e infrastrukturës së DRS në Datacenterin qeveritar në AKSHI.

- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC sipas nenit 4 të Kushteve të veçanta të kontratës

përcaktohet se shërbimet do të kryhen sipas përcaktimeve në ofertën teknik, ku sipas përcaktimeve në ofertën teknike bashkëlidhur kontratës rezulton se vendodhja është përcaktuar përsëri në Datacenterin qeveritar në AKSHI, e cila nuk është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, ku kushtet dhe distanca e ndërtimit të një ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë gjithmonë në një pozicion gjeografik që ka risk shumë të ulët që të përfshihet nga i njëjti incident apo fatkeqësi natyrore nga ambienti primar, minimalisht 50 km distancë në vijë ajrore.

- Autoriteti Kontraktor (AKSHI) nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zbatimit të kontratës me operatorin ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

- Nga AKBN nuk janë kryer asnjëherë testime për Disaster Recovery Site mbi funksionalitetet e tij në rast se do të ndodhnin evente me pasoja negative (rreziqe natyrore, katastrofa etj) në AKBN, duke sjellë risk të lartë në ndërprerje të shërbimeve dhe kohë të pacaktuar për rikthimin e shërbimeve dhe të dhënave në funksionalitet të plotë.

- Ky shërbim nuk është ofruar nga AKSHI në kundërshtim me kreun II, pika 5, shkronja e), të VKM-ës Nr. 673, datë 22.11.2017, ku sipas Listës nr. 1 “Katalog Shërbimesh”, ndër shërbimet qeveritare është dhe Disaster recovery, “*Ofrimi i një site-i dytësor në strukturën e AKSHI-t në raste fatkeqësish*”.

Përsa më sipër vlera e investimit në shumën 52,650,000 lekë (pa TVSH) që mund të shmangej (të ofrohej nga AKSHI), përbën investim pa efektivitet për institucionin.

- Nga auditimi konstatohet se i gjithë procesi i raportimeve për subjektet minerare në sistem ngelet në statusin AKBN (Kontrollon), duke mos bërë dokumentimin si dhe gjurmimin rast pas rasti për secilin raportim që bëhet nëpërmjet sistemit. Nga auditimi konstatohet se subjektet për një raportim sipas udhëzimeve përkatëse mund të plotësojnë disa rekorde dhe ti dërgojnë në fazën AKBN (Kontrollon) pa marrë feedback nga rekordi i parë i plotësuar në sistem. Konstatohet se për disa subjekte ekzistojnë në sistem 2 ose më shumë rekorde për një fazë raportimi. Sistemi gjeneron raport për të gjitha rekordet e hedhura dhe pse një pjesë e tyre mund të ketë të dhëna të pa plotësuara ose të jenë dublikim për të njëjtin subjekt. Të gjitha këto raste kontrollohen dhe modifikohen manualisht nga punonjësit e sektorit të Procedurave Statistikës, Garancive Financare, Koordinimit dhe GIS me qëllim gjenerimin e raportimeve informative për AKBN dhe MIE.

- Nga auditimi mbi miratimin e planeve vjetore që subjektet duhet të bëjnë nëpërmjet sistemit konstatohet se nuk reallizohet/përdoret nëpërmjet sistemit dhe pse është bërë i mundur konfigurimi që ky shërbim të bëhet nëpërmjet tij. Komisioni i cili ka akses të plotë për të parë dosjet dhe për ti verifikuar dhe për të proceduar me dosjet përkatëse nuk është loguar asnjëherë në sistem me qëllim marrjen e informacionit dhe e gjithë proceduar bëhet me dosje fizike.

- Nga auditimi konstatohen raste kur subjektet minerare kanë raportuar jashtë afateve sipas përcaktimeve ligjore për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë për të cilët nuk është aplikuar gjobë sipas legjislacionit në fuqi. Sistemi nuk ka kontrole për raportimet e subjekteve të cilat janë jashtë afatit ligjor. Afati i raportimeve që bëjnë subjektet nuk ka politikat e kontrollit në sistem për të parë vlefshmërinë e tij, konstatohet se sistemi i lejon subjektet të bëjnë raportimet dhe pse janë jashtë afatit ose para afatit dhe verifikimi për këto subjekte bëhet manualisht pas faktit.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave të Sigurisë së Informacionit dhe në mbështetje të saj të hartojë një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit si hapi fillestar ku bazohen elementët e ndryshëm që i shërbejnë sigurisë, planifikimit dhe zhvillimi të sistemeve, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore aktuale të IT-së, të cilët ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale.

- Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e sistemeve kritike, të dhënat kritike dhe konfidenciale të cilat i akseson në vazhdimësi apo përkohësisht, si dhe përcaktimet e nivelit të aksesit në të dhënat e backup për sistemet. Gjithashtu të hartojë dhe miratojë planet e vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në vijimësi të marrin masa mbi organizimin e procedurave të prokurimit ku të analizojnë, argumentojnë dhe dakordësojnë nevojën për përdorimin e tyre për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve në të ardhmen, si dhe të shmangët përcaktimi i fondit limit mbi fondet e planifikuara dhe miratuara në buxhetin e AKBN-ës.
- Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë rasteve përse është konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim mbylljen e të gjitha proceseve të raportimeve që bëhen nëpërmjet sistemit sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me limitimin e numrit të aplikimeve që krijojnë subjekti, duke marrë masat e nevojshme për implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit në sistem, për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemit, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara mbi popullimin e të dhënave dhe rritjes së rasteve të dublikuara në sistem.
- Strukturat përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa të menjëhershme për fillimin e përdorimit dhe popullimin e moduleve ekzistuese të cilat janë implementuar në sistemin Revzone, nga të gjitha strukturat sipas detyrave dhe funksioneve përkatëse, me qëllim automatizimin dhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të cilat është investuar për këtë sistem.
- Sektori i IT-së dhe Dixhitalizimit të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për automatizimin e plotë të këtij shërbimi me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit në ofrimin e shërbimeve.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vlerësojmë se sistemi informatik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore të Republikës së Shqipërisë (Revzone), si dhe sistemi i menaxhimit të licensave dhe koncesioneve (GIS) kanë mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen, përdorimin dhe vazhdimësinë e funksionimit të tyre. Me gjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AKBN në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera, nisur nga fakti se zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë. Mungesa e rregulloreve për përdorimin e sistemeve që AKBN disponon ka krijuar mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar. Nga analizi i të dhënave në sistemin për lejet minerare, rezultoi se sistemi Revzone nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit në sistem me të dhëna të cilat tejkalojnë përmbushjen e afateve sipas deklarimeve që duhet të bëjnë subjektet si dhe dublikimin e informacioneve, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta. Sistemet e informacionit nuk kanë arritur qëllimet e investimeve të kryera në lidhje me informatizimin e proceseve, zhvillimin e shërbimeve si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë në ofrimin e shërbimeve.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 477/1 prot., datë 19.04.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.04.2024 deri më datë 10.07.2024, në subjektin “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.S, përgjegjës grupi;
2. A.A, auditues;

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në AKBN, nga data 22.04.2024 deri më datë 10.07.2024. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 477/1 Prot, datë 19.04.2024:

1. Siguria e informacionit

1.1 Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit

2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

2.1 Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit

3. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka si objekt të veprimtarisë së saj, zhvillimin, mbikqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Misioni dhe vizioni i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore është të mbroj dhe mire administrojë interesat e shtetit Shqiptar në fushat hidrokarbure, minerare dhe energjitike.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi AKBN mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 477/1 Prot., datë 19.04.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*;
- Ligji nr. 2/2017, *“Për sigurinë kibernetike”*;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, *“Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”*;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 547 datë 09.08.2006 *“Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 *“Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”*;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
- Standardet TIK, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetë sorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumenteve ligjorë, për sistemet informatike qw institucioni disponon;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, është person juridik, ent publik, në varësi të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është krijuar nga bashkimi i Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektive të Metalurgjisë, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve dhe Institutit të Studimeve dhe Projektive të Mekanikës dhe Drurit dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë.

Fusha e veprimtarisë së AKBN konsiston në:

- a) Propozimin, konsultimin, dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të Qeverisë për hartimin e politikave të saj dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- b) Zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- c) Sigurimin brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe të energjisë, të paraqitura nga subjektet shtetërore a privatë, vendas ose të huaj. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
- d) Promovimin e burimeve minerare, hidrokarbure, hidrike dhe burimeve të rinovueshme të energjisë;
- e) Negocimin e marrëveshjeve hidrokarbure dhe minerare dhe ndjekjen e zbatimit të planeve të zhvillimit të tyre;
- f) Përgatitjen e dokumentacionit dhe praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas marrëveshjeve të lidhura;
- g) Ndjekjen e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;
- h) Mbikëqyrjen e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- i) Realizimin e monitorimit të zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
- j) Monitorimin, e kontratave konçensionare për hidrocentralet;
- k) Administrimin ekskluzivisht të të gjitha të dhënave parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare;
- l) Propozimin e masave për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;
- m) Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Siguria e informacionit

1. Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit

Në zbatim të pikës 1.a “*Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Verifikime onsite të dhomës së serverave të AKBN dhe infrastrukturës networku të institucionit;
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Politikat mbi Sigurinë e Informacionit;
- Verifikimi i dokumenteve të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat;
- Konsultim me faqen e web-it të AKBN, etj.

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Meqenëse për periudhën nën auditim (01.01.2021-31.12.2023) sipas përcaktimeve të VKM-ës nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, AKSHI është institucioni përgjegjës për sistemet, infrastrukturën hardware dhe software, koordinimin e bazës së të dhënave, menaxhimin e strukturës TIK etj. Referuar VKM-ës nr. 673, datë 22.11.2017, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, në pikat e mëposhtme citohet se:

18. *Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.*

19. *Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.*

20. *Harton planin e transferimit nën administrimin e AKSHI-t të aseteve që preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi.*

Nga auditimi u konstatua se AKBN ka në administrim sistemet “RevZone” dhe “GIS”. AKBN gjatë ushtrimit të detyrave të tij funksionale është përdorues i këtyre dy sistemeve të cilët janë ndërtuar dhe implementuar nga Operatorët. Gjithashtu AKBN në funksion të përmbushjes së detyrave të tij përdor edhe platformat e tjera Qeveritare të mundësuar nga ASKHI, konkretisht:

- e-Albania;
- Platformën e bashkëqeverisjes;
- Sistemin e tatimeve;
- Sistemin e fiskalizimit;
- Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE);
- Sistemin HRMIS.

Në tabelën e mëposhtme janë specifikuar pajisje të infrastrukturës TIK të hostuara në ambientet e AKBN-ës dhe një pjesë e tyre në Datacenter-in qeveritar në AKSHI, të cilat janë kryesisht infrastrukturë network:

Tabela nr.1. Pajisjet fizike të AKBN

Nr	Përshkrimi	Sasi
1	Mail Security Barracuda Email Security Gateway VX V300	1
2	NGFW VPN Barracuda CloudGen Firewal F400 F20	2
3	Load Balancer Barracuda Load Balancer ADC 540	2

4	Sistem NAC Aruba ClearPass NL AC 500 CE E-LTU Aruba ClearPass NL OB 100 USR E-LTU	1
5	Swich HPE 5710 24SFP+6QSFP+/2QSFP28 Swich	2
6	Access Point WiFi Aruba AP-303 (RW) Unified AP	40
7	Swich Akses /Agregimi Aruba 2930F 48G PoE+4SFP+Swich	6
8	Shasi per server blade HPE SYNERGY 12000	1
9	Server HPE SYNERGY 480 GEN10	4
10	Storage IBM FlashSystem 5100	1
11	UPS HPE G2 R6000/60309 3-Wire 32 A/230V Outlets (4) C13 (4) C19(1) IEC 32A/3U Rackmount Intl UPS	2
12	Shtesa San switch - blloqe ushqimi (server)	1
13	Server per virtualizem dhe hyper -V (server)	4
14	Back up - server	1
15	Tape library - server	1
16	Back up software -server	1
17	Core switch-server	2
18	Gateway firewall-server	1
19	Casemangnet licensa	30
20	Busines proceses-licensa	30
21	Busines Intelegjente	30
22	CRM+palët e treta	30
23	CRM (akses komunikimi)	1
24	Webforms server license	30
25	Webaces -license pa limit	1
26	Integrations with other sistems licensa	1
27	Blade server	2
28	Storage Expansion	1
29	Programi Financa 5(4 poste pune + 1 server)	1
Pajisjet fizike të cilat janë hostuara në datacenter-in e AKSHI-t (të cilat janë në inventar të AKBN-ës)		
30	Swich-HPE 5710 24SFP+6QS+/2QS28	2
31	Server për Aplikim-HPE DL360 Gen10 CTO Server	2
32	Server për Aplikim dhe Backup-HPE DL360 Gen10 C	1
33	Storage-IBM FlashSystem 5100	1
34	BackUp Disc to Disc HPE StoreOnce 3620	1
35	BackUp Disc to Tape HPE StoreEver MSL2024	1
36	Kaseta për Tape Libr HPE LTO 7 15TB RW Data CRTG	24
37	BackUP Software Veem Backup Replication	1

Burimi: AKBN

AKBN nuk e ka përfunduar procesin e dorëzimit të Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar. Megjithëse duhet të përmendim se përgjatë fazës së zhvillimit të auditimit në terren, AKSHI me anë të shkresës nr. 3778 prot., datë 06.12.2017 i është drejtuar AKBN-ës në lidhje me zbatimin e VKM-ës nr. 673, datë 22.11.2017, ku kërkohet dokumentacion për çdo sistem dhe infrastruktur TIK ekzistues dhe kodin burim, të cilat duhet të kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse. AKBN me anë të urdhrin nr. 2371, datë 21.12.2017 ka ngritur grupin e punës “Për dorëzimin pranë AKSHI-t, të dokumentacionit të plotë të sistemit dhe infrastrukturës TIK ekzistues dhe kodin burim, të AKBN-ës”. Grupi i punës ka plotësuar dokumentacionet dhe formularin përkatëse për kalimin e infrastrukturës hardware dhe i ka dërguar me anë të shkresës nr. 2847, datë 08.03.2018 në AKSHI. Gjithashtu janë caktuar dhe personat e ngarkuar të cilët do të

evidentojnë dhe kryejnë kalimin kapital të infrastrukturës hardware dhe sistemet IT tek AKSHI.

Komunikimi i fundit në lidhje me zbatimin e VKM nr. 673, datë 22.10.2017, nga AKBN me AKSHI-in është shkresa me nr. 9356, datë 05.12.2018, ku AKBN parashtron kërkesën e saj për informacion lidhur me statusin e Sektorit të IT dhe Dixhitalizimit.

Me anë të shkresës nr. 5240 Prot., datë 03.09.2019, protokolluar në AKSHI dhe shkresës nr. 2453/6, datë 09.09.2019, protokolluar në AKBN, është nënshkruar urdhri vetëm nga AKSHI, me qëllim përcaktimin e listës së aktiveve për infrastrukturën hardware dhe sistemet IT, objekt kalimi kapital, si dhe identifikimin e të drejtave dhe detyrimet e institucioneve në lidhje me aktivet. Afati i zbatimit të këtij urdhri ishte deri në 7 ditë kalendarike nga nënshkrimi i tij.

Referuar këtij urdhri të përbashkë, nga ana e AKBN-ës nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij urdhri. Gjithashtu referuar VKM-ës nr. 673, datë 22.11.2017, IV. “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, në pikën 20, citohet se: *“Harton planin e transferimit nën administrimin e AKSHI-t të asetëve që preken nga fusha e veprimit të këtij vendimi”*, për të cilën në vijimësi nga AKSHI nuk është administruar asnjë përgjigje.

- Topologjia e suportit të ofruar nga AKSHI për AKBN janë licenca Microsoft, hostimin e faqes web të AKBN-së dhe DNS publike, shërbime të cilat janë pjesë katalogut të shërbimeve përcaktuar në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella midis AKBN-ës dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI ASHK-së sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”.

Nga auditimi u konstatua se, nuk është kryer procesi i kalimit në AKSHI sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtarë të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Kanë kaluar rreth 5 vite nga korespondenca e fundit ndërmjet AKBN dhe AKSHI, ky mos organizim në lidhje me sistemet, sigurinë, infrastrukturën e AKBN-s, ndikonë në mos arritje të objektivave institucionale, si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave, përgjegjësive dhe investimeve të kryera sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

➤ **Verifikimi i sigurisë fizike**

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Nisur nga fakti që infrastruktura e dhomës së serverëve është vendi ku sistemet informatike të qendëruara ruhen dhe ofrohen për shërbime të brendshme dhe të jashtme të institucionit, përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të Sektorit IT dhe Dixhitalizimit, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të AKBN-ës dhe aksesin në rrjet.

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në AKBN, u konstatuan disa problematika si mëposhtme:

- Nuk ka një rregullore/udhëzues të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Sistemi i akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar nuk është i aktivizuar;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë se aksesit në ambientin fizik.
- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluara nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dyshe me teknologjike e përlogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbetje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës;
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- U konstatua mungesa e kamerave të sigurisë në dhomën e serverëve për monitorimin e hyrje-daljeve dhe veprimtarisë brenda në sallë;
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, qese, dërrasa, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.

Fig. Nr. 2: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën qendrore të AKBN-ës dhe asetëve të ndodhura në të



Burimi: Grupi i Auditimit

➤ **Mbi përdorimin e infrastrukturës TIK në AKBN**

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në AKBN mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet.

Nga auditimi u konstatua se siguria e informacionit në AKBN mbart risqe që vijnë për shkak se sistemet e operimit apo programet e instaluar në kompjuterat dhe pajisjet PC të AKBN-ës nuk janë të gjitha të licencuara dhe nuk kanë versionet të përditësuara si dhe nuk përdorin për mbrojtje antivirus si dhe kryesisht pajisjet kompjuterike nuk kanë të përditësuara sistemet e sigurisë, konkretisht:

- Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 65%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të AKBN-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;
- Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;

- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc nuk janë të gjitha të licencuara;
- Në këta kompjutera nuk mund të bëhet upgrade në Windows 10/11;
- Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra, por edhe të amortizuara.

➤ ***Sigurisë e informacionit në drejtim të politikave të sigorisë***

Nisur me zhvillimet teknologjike që AKBN ka implementuar së fundmi konstatohet se, AKBN nuk disponon Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një drejtim strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit në termat e politikave të sigorisë, mbulimin e saj, ndërgjeshmëria në nivel institucional.

Gjithashtu konstatohet se AKBN nuk ka një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat strategjik të institucionit në lidhje me IT, kapaciteti aktual i TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve, duke marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës së IT, investimeve, modelin e ofrimit, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët, për të mbështetur objektivat e institucionit.

➤ ***Procedura e ndjekur për backup***

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se procedurat për backup të sistemeve të AKBN-së realizohet automatikisht në nivel makine, nuk realizohet backup në nivel aplikacioni ose database. Backup realizohet në serverat e ngritur në ambientet e AKSHI-t për realizimin e Disaster Recovery dhe komunikimi midis Primary Site dhe Disaster Recovery Site realizohet nëpërmjet rrjetit gov-net të AKSHI-t nëpërmjet switche-ve layer 3 të instaluar në të dy pikat fundore.

Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e AKBN. Procedura aktuale kryhet me anë të Operatorit përkatës dhe personit që është ngarkuar si ndjekës i kontratës.

Gjithashtu u konstatua se nuk janë përcaktuar nivelet e aksesit në të dhënat e backup për sistemet që menaxhohen bazuar në kontratat e lidhura për të cilat AKBN është përfituesi.

Kjo situatë, në opinion të grupit të auditimit, përbën risk të lartë për sa i përket sigurisë së të dhënave të institucionit, pasi në rast të një dëmtimi, humbjeje apo komprometimi të këtyre të dhënave, nuk ka asnjë person i cili mban përgjegjësi për to.


➤ ***Active Directory***

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se AKBN për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ka në përdorim “Active Directory”, Windows Server 2019 Standard. Administratorët që përdorin Active Directory është stafi i Sektorit të IT-së dhe Dixhitalizimit.

Nga auditimi u konstatua se Administratori i bazës së të dhënave të Active Directory dhe detyrat e tij nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të AKBN, sipas funksioneve dhe të gjitha detyrat e administratorit mbi administrimin e bazës së të dhënave të Active Directory.

Nga auditimi u konstatua se konfigurimet e Active Directory janë të konfiguruar by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me standardet me të mira. Këto politika të sigurisë konfigurohen sipas rëndësisë që i kushtohet këtyre elementëve, në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë së aksesit.

Fig nr. 3: Politikat e sigurisë së fjalëkalimeve në Active Directory



Burimi: Grupi i Auditimit, AD AKBN

Nga auditimi mbi Advanced Audit Policy Configuration Settings u konstatua se konfigurimet nuk janë në përputhje me praktikat më të mira, duke rritur riskun që ngjarjet e sigurisë nuk mund të përditësohen ose nuk do të mund të ndiqen për arsye se mungon një regjistër (log).

Fig nr. 4: Politikat e sigurisë në Active Directory





Fig nr. 5: Politikat e sigurisë në Active Director



Burimi: Grupi i Auditimit, AD AKBN


Nga auditimi u konstatua se Ekzistojnë Njësi Organizative në sistem të cilat janë të krijuara dhe nuk kanë asnjë user; gjenden usera të cilët janë të pa identifikueshëm me emra si Test Test, Test 2, user test, akbn akbn si dhe raste të tjera të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet dhe në rrjetin e AKBN, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

➤ **Faqja Web**

Për testimin e performancës së faqes së internetit u bënë disa pen-test për sjelljen e faqes web sipas browserit të zgjedhur, si dhe disa teste të thyerjes së sigurisë dhe mangësive. Kjo metodë përdoret për gjetjen e gabimeve siç është “404’s” ose probleme më komplekse siç janë burimet e jashtme që bllokojnë pasqyrimin e faqes (page rendering).

Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web (<http://www.akbn.gov.al/>) u konstatua se AKBN nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.

Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali. Gjithashtu një sulmues i jashtëm, i cili arrin të hyj në rrjeti, ka mundësi të lexojë dhe ndryshojë informacionin i cili aksesoret nga rrjeti, duke përfshirë (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive).



➤ **Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash, nevojiten të hartohen plane të rikuperimit nga katastrofa (DRC), në të cilat dokumentohen masat dhe procedurat për rivendosjen në funksionim të sistemit me qëllim garantimin minimal të shërbimeve që ofrohen nëpërmjet sistemeve informatike, funksionet kritike, kohën e rikuperimit si dhe burimet njerëzore që përfshihen në rast emergjence.

AKBN ka investuar për ngritjen e një Disaster Recovery Site (DRS) për të garantuar vazhdueshmërinë e biznesit, e cila është e lokalizuar në Datacenter-in qeveritar në AKSHI. Nga auditimi u konstatua se, AKBN pavarësisht se ka marrë masa të konsiderueshme për ngritjen e një infrastrukture të nevojshme për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës, konstatohet se AKBN nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center), në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, pika 1, si dhe nuk ka bërë të mundur evidentimin e sistemeve kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës.

Gjithashtu konstatohet se AKBN nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013. Në këto dokumente përcaktohen masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

➤ **Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve**

Objekivi: Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të politikave dhe procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve.

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe komunikimi i brendshëm institucional si dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet TI që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet nëpërmjet e-mail-eve, komunikimeve me celular apo shkëmbimeve verbale.

Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI, sipas praktikave më të mira. Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores

për trajtimin e incidenteve bën që AKBN të mos identifikojë dhe menaxhojë risqet me efekt negativ në TI dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim të trajtimit të gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e TI në AKBN. Pasja e procedurave të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e incidenteve dhe problemeve ul riskun e, aksesit të paautorizuar të përdoruesve edhe ndërhyrjet e paautorizuara; dështimeve të rrjetit, funksionalitetit të ulët të programeve (ofrimi i shërbimeve).

➤ *Burimet njerëzore*

AKBN funksionon sipas strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr. 248, datë 12.03.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si pjesë e pandarë e Statut-Rregullores së funksionimit të AKBN-ës. Detyrat specifike dhe përshkrimet e punës së punonjësve të AKBN-ës janë pjesë përbërëse e Rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 7, datë 20.06.2018 “Për miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në rregulloren e Brendshme të AKBN-së”.

Struktura e AKBN-ës është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

- a) Drejtori Ekzekutiv
- b) Zv. Drejtori Ekzekutiv
- c) Këshilltarë
- d) Drejtor Drejtorie
- e) Shef Sektori
- f) Specialist i parë
- g) Specialist


Drejtoritë janë strukturuar bazë të AKBN-ës në varësi të drejtëpërdrejtë të Drejtorit Ekzekutiv dhe janë 9 (nëntë) Drejtori si më poshtë:

- Drejtoria e Shërbimeve Ligjore;
- Drejtoria e Administratës;
- Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun;
- Drejtoria Ekonomike;
- Drejtoria Minerare;
- Drejtoria Monitorimit të HEC-ve;
- Drejtoria Hidrokarbure;
- Drejtoria Procedurave Hidrokarbure;
- Drejtoria e Energjive të Rinovueshme

Drejtoritë e mësipërme, në varësi të fushës dhe detyrave specifike që mbulojnë, në strukturën e tyre jenë të organizuar në bazë të sektorëve, të cilët funksionojnë bazuar në detyrat e përcaktuara në Statut-Rregullore dhe në Rregulloren e brendshme të AKBN-së.

Spektori i IT dhe Dixhitalizimit është në varësi të Drejtorisë së Administratës dhe përbëhet nga 3 (tre) punonjës, nga të cilët 1 (një) shef sektori dhe 2 (dy) specialistë.

Fig.1: Struktura e Sektorit të IT dhe Dixhitalizimit



Burimi: AKBN, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në AKBN për periudhën e auditimit rezulton se Sektori i IT dhe Dixhitalizimit në strukturën e saj ka patur në përbërje një specialit i cili është jashtë profilit të IT, detyrat e të cilit janë realizuar nga pjesa tjetër e stafit të Sektorit duke qenë se janë pjesë e ndjekjeve të kontratave përkatëse.

➤ *Trajnimet*

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.

Nga auditimi u konstatua se, AKBN për periudhën objekt auditimi 2021-2023, nuk ka patur plan trajnimi vjetor si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore të Sektorit të IT-ës dhe Dixhitalizimit. Trajnimet e përfituara nga zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacioni për stafin IT.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1977/14 prot., datë 02.09.2024 “Mbi Projekt Raportin e KLSH-së me nr. 477/5, datë 29.07.2024”, ku nga shqyrtimi i tyre rezultoi se këto observacione janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të paraqitura me shkresën nr. 1977/11, datë 18.07.2024 të bëra nga subjekti për Aktkonstatimin nr. 1, datë 10.07.2024, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projekt Raport. Gjithashtu për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit Nga AKSHI është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3723/1 prot., datë 29.08.2024 “Dërgim observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) nuk është vënë në dijeni për fillimin e procesit të auditimit, gjatë fazës së auditimit në terren, si dhe nuk është njohur me akt-konstatimet e mbajtura në mënyrë që të përcillte observacionet përkatëse, në lidhje me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit.

AKSHI ka një marrëveshje të nivelit të shërbimit (SLA) me Nr. 1284 prot., datë 15.03.2018 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ka në varësi AKBN-në. Pra, ky rekomandim duhet të jetë për AKBN-në, e cila duhet të ndërmarri të gjitha hapat e nevojshme për zbatimin dhe përmbushjen e tij. AKSHI mbetet i hapur të bashkëpunojë me kërkesë të AKBN-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se përsa kohë AKBN nuk ka realizuar procesin e kalimit tek ju, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK sipas VKM nr. 673 datë 22.11.2017, subjekti i auditimit ka qenë AKBN.

Përsa i përket vënies në dijeni për fillimin e procesit të auditimit, ju rikujtojmë se, nga ana e personit të kontaktit caktuar nga AKBN, jeni vënë në dijeni disa herë, si në rrugë elektronike ashtu dhe me shkresën zyrtare nr. 1977/2, datë 22.05.2024, protokolluar nga AKBN, ku nga ana e AKBN është kërkuar vendosje në dispozicion të dokumentacionit përsa është kërkuar nga grupi i auditimit. Nga ana juaj nuk është kthyer asnjë përgjigje deri në momentin kur AKBN detyrohet të autorizojë një punonjës për të tërhequr materialet, të cilat duhet ti administronte edhe AKBN.

Referuar marrëveshjes së nënshkruar nga ju me MIE që në vitin 2018, sjellim në vëmendjen tuaj se, vitet e fundit AKBN ka bërë investime të konsiderueshme në fushën e teknologjisë së informacionit, për të cilat ju jeni në dijeni si Autoritet Kontraktor, ku sipas përcaktimeve të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, shërbimet do ofroheshin dhe monitoroheshin bazuar në këtë VKM. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 2.1. “Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2023;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

a. Investimet në teknologjinë e informacionit

Procedurat mbi teknologjinë e informacionit, realizuar nga AKBN për periudhën objekt auditimi, janë:

Nr.	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1.	Shërbim interneti për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier	2021	145,000
2.	Blerje Bojë printeri	2021	440,000
3.	Riparim kompjuteri dhe fotokopje	2021	99,166
4.	Sistem Check in-out	2021	478,900
5.	Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier	2022	144,850
6.	Pjesë për fotokopje dhe kompjutera	2022	486,000
7.	Riparim i kompjuterave dhe fotokopjeve	2022	100,000
8.	Blerje bojë printeri	2022	478,890
9.	Blerje pajisje kondicionimi për dhomën e serverave	2022	364,000
10.	Blerje pajisje për kamerat e sigurisë	2022	100,000
11.	Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier	2023	178,500
12.	Bojë printeri	2023	571,440

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

- 1- Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier (2022)”;
- 2- Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Bojë printeri”;

❖ Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier (2022)”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 66, datë 11.04.2022	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: S.H R.M D.M	4. Komisioni i llogaritjes së fondit limit: S.H R.M D.M
2. Fondi Limit (pa tvsh) 156,000 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: S.H R.M D.M	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: S.H R.M D.M
8. Data e hapjes së tenderit: 11.04.2022	9. Operatori fitues: “M.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 144,850 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 11,150 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 6 (gjashtë)	12. Operatorë të Kualifikuar: 2 (dy)	13. Operatorë të skualifikuar: 4 (katër)

14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 15.04.2022	18. Vlera e kontratës (pa tvsh): 144,850 lekë	19. Afati i kontratës: 12 muaj

Të dhënat për procedurën e prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe dokumenteve standarde, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 8 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		Operatorët Ekonomikë të Skualifikuar	
M.	144,850.00	V.	
B.	155,000.00	A.	
		T.	
		A.	

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

Marrja në dorëzim i shërbimit është përcaktuar në kontratë konkretisht pika 11.1 në nenin 11 – Përfaqësimi i Palëve, ku citohet se: Në emër të AKBN përgjegjës për marrjen e komunikatave dhe përfaqësimin në çështje të lidhura me ekzekutimin e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës, do të jetë Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Dixhitalizimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i IT dhe Dixhitalizimit me shkresën nr. 719/3 Prot., 15.03.2022 i ka drejtuar një kërkesë Drejtorisë së Administratës për nisjen procedure mbi ofrimin e shërbimit të internetit.

- Më datë 10.04.2022 është mbajtur procesverbali i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me blerje të vogël “Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier”. Ky procesverbal nuk është protokolluar nga institucioni.

- Fondi limit i përllogaritur nga AKBN është në vlerën 156,000 lekë pa TVSH bazuar në çmimet e tregut, për të cilën komisioni i prokurimit mori tre oferta, si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta
M.	155,000 lekë pa TVSH
E.	157,000 lekë pa TVSH
E.	156,000 lekë pa TVSH

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

- Me shkresën nr. Prot., 719/5, datë 11.04.2022 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 66, datë 11.04.2022 për prokurimin me vlerë të vogël nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Përfitimi i shërbimit të internetit për godinat e AKBN në Tiranë Fier” referuar kërkesës nr. 719/3 prot., datë 15.03.2022.

- Me shkresën nr. Prot., 719/6 datë 11.04.2022, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka bërë ftesën për ofertë ku ka përcaktuar specifikimet teknike si dhe afatet e kryerjes së shërbimit.

- Më datë 11.04.2022 është bërë hapja e procedurës nga 3 anëtarët e komisionit si dhe kanë realizuar klasifikimi përfundimtar të ofertuesve pjesëmarrës.

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar	Vlera e Ofruar
M.	144,850.00
B.	155,000.00

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

Operatorët ekonomik: V., A., T. dhe A. janë skualifikuar për shkak të tejkalimit të fondit limit.

- Raporti përmbledhës REF-24665-04-11-2022, gjeneruar nga sistemi elektronik SPE, mbi shpalljen fitues të operatorit “M.”.

- Përsa më sipër është kryer pagesa për këtë kontratë me vlerë 144,850 lekë pa tvsh për periudhën nga data 15.04.2022 deri më 15.04.2023 sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Nga auditimi u konstatua se procesverbali i shpalljes së fituesit dhe procesverbali i skualifikimit të operatorëve nuk rezulton të jetë mbajtur nga njësia e prokurimit dhe të jetë bërë pjesë e dosjes.

Procesverbali për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit nuk është protokolluar nga institucioni. Mungesa e siglimit të dokumenteve sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe me “Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuar”, të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

❖ Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s” (2023)

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 146, datë 24.07.2023	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: S.H A.B M.G	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: S.H A.B M.G
2. Fondi Limit (pa tvsh) 571,440 lekë		
5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: S.H A.B M.G	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: S.H A.B M.G
8. Data e hapjes së tenderit: 25.07.2023	9. Operatori fitues: “I.” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 300,000 lekë	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 211,440 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 17 (shtatëmbëdhjetë)	12. Operatorë të Kualifikuar: 13 (katërmëdhjetë)	13. Operatorë të skualifikuar: 3 (tre)
14. Ankimimet: -	15. Përgjigje Ankesës nga AK -	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: -
17. Marrja në Dorëzim Datë 31.07.2023	18. Vlera e kontratës (me tvsh): 360,000 lekë	19. Afati i kontratës: 1 ditë

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe dokumenteve standarde, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

- Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 17 Operatorë Ekonomik. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar		Operatorët Ekonomikë të Skualifikuar
I.	286,000.00	R.
I.	300,000.00	H.
L.	340,000.00	A.
B.	345,350.00	
P.	356,900.00	
B.	388,900.00	
A.	424,500.00	
C.	439,000.00	
E.	488,800.00	
T.	490,000.00	
A.	500,000.00	
S.	533,333.00	
O.	534,000.00	
J.	566,667.00	

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

- Operatori ekonomik: “I.” ka njoftuar në SPE që tërhiqet nga realizimi i procedurës për shkak të llogaritjes së gabuar të ofertës ekonomike. Në këto kushte Komisioni vendosi skualifikimin e këtij operatori dhe kalimin tek operatori i rradhës: “I.”. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbal në datë 27.07.2023 në AKBN për kalimin tek Operatori Ekonomik i rradhës si dhe shpalljen e fituesit për ofertën e Operatorit Ekonomik të renditur në vendin e parë “I.” me vlerë 300,000 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s”.

- Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit:

Me datë 31.07.2023 në AKBN është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Zhvillimi i kontratës:

- Sektori i Shërbimeve të Brendshme me shkresën nr. 2550 Prot., 22.05.2023 i ka drejtuar një kërkesë Drejtorisë së Administratës për blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-së.

- Më datë 18.07.2023 është mbajtur procesverbali i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, për procedurën e prokurimit me blerje të vogël “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s”. Ky procesverbal nuk është protokolluar nga institucioni.

- Fondi limit i përlllogaritur nga AKBN është në vlerën 571,440 lekë pa TVSH me procesverbalin e mbajtur më 19.07.2023. Ky procesverbal nuk është protokolluar nga institucioni.

Më 19.07.2023 komisioni i prokurimit mori tre oferta, si më poshtë:

Operatori Ekonomik	Oferta
C.	599,843 lekë pa TVSH
I.	568,609 lekë pa TVSH

I.	545,857 lekë pa TVSH
-----------	----------------------

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

Komisioni është i përbërë nga S.H, A.B dhe M.G. Ky komision është i njëjtë për specifikimet teknike, për përlogaritjen e fondit limit, për vlerësimin e ofertave si dhe për marrjen në dorëzim të mallit. Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

- Me shkresën nr. Prot., 2550/1 datë 24.07.2023 është miratuar Urdhri i prokurimit nr. 146, datë 24.07.2023 për prokurimin me vlerë të vogël nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN. Urdhri i prokurimit me vlerë të vogël ka si objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-së” referuar kërkesës nr. 2550 prot., datë 22.05.2023.

- Me shkresën nr. Prot., 2550/2 datë 24.07.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka bërë ftesën për ofertë ku ka përcaktuar specifikimet teknike si dhe afatet e kryerjes së shërbimit.

- Më datë 26.07.2023 është bërë hapja e procedurës nga 3 anëtarët e komisionit si dhe kanë realizuar klasifikimi përfundimtar të ofertuesve pjesëmarrës.

Operatorët Ekonomikë të kualifikuar	Vlera e Ofruar
I.	286,000.00
I.	300,000.00
L.	340,000.00
B.	345,350.00
P.	356,900.00
B.	388,900.00
A.	424,500.00
C.	439,000.00
E.	488,800.00
T.	490,000.00
A.	500,000.00
S.	533,333.00
O.	534,000.00
J.	566,667.00

Burimi: AKBN. Punoi Grupi i Auditimit

Operatorët ekonomik: R., H. dhe A. janë skualifikuar për shkak të skualifikimit në procedurën “Blerje pjese fotokopje”, pasi nuk janë paraqitur në AKBN dhe nuk kanë njoftuar në SPE arsyet e mosparaqitjes pas njoftimit. Nga auditimi u konstatua se Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël nuk kanë mbajtur procesverbal mbi skualifikimin e operatorëve ekonomik, për procedurën me objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s”.

- Më datë 27.07.2023, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka mbajtur procesverbalin për skualifikimin e operatorit I. pasi ka njoftuar në SPE që tërhiqet nga realizimi i procedurës për shkak të llogaritjes së gabuar të ofertës ekonomike, si dhe komisioni vendos skualifikimin e këtij operatori dhe kalimin tek operatori ekonomik i rradhës.

- Raporti përmbledhës REF-75874-07-25-2023, gjeneruar nga sistemi elektronik SPE, mbi shpalljen fitues të operatorit “I.”.

- Përsa më sipër është kryer pagesa në datë 17.10.2023 me faturë tatimore 3120/2023 në vlerën 300,000.00 pa TVSH.

Nga auditimi u konstatua se:

- AKBN nuk ka hartuar një raport përmbledhës mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s” siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në nenin 84 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të

hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj;

- procesverbali i shpalljes së fituesit nuk rezulton të jetë mbajtur nga njësia e prokurimit dhe të jetë bërë pjesë e dosjes;

- asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës;

- një sërë shkresash në dosjen e procedurës me vlerë të vogël me objekt “*Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s*” nuk janë protokolluar nga institucioni. Shkresat të cilave i mungon numri i protokollit janë:

1. Procesverbali për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit;
2. Procesverbali për llogaritjen e fondit limit;
3. Procesverbali për skualifikimin e operatorit;
4. Procesverbali i marrjes në dorëzim.

Mungesa e siglimit të dokumenteve të mësipërme sjell mangësi dhe nuk jep gjurmë mbi vërtetësinë e shkresave zyrtare të dosjes së tenderit në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*” dhe me “*Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “*Arkivat e numerizuar*”, të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*”.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1977/14 prot., datë 02.09.2024 “*Mbi Projekt Raportin e KLSH-së me nr. 477/5, datë 29.07.2024*”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: ... argumentojmë se realizimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s*”, është kryer nga Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël i krijuar me urdhërin e Drejtorit Ekzekutiv me nr. 12, datë 26.01.2023 ... Sa më sipër përzgjedhja e anëtarëve të komisionit, nuk ishte kompetencë e Komisionit me vlerë të vogël, por e titullarit të Entit Prokurues. Në këto kushte nuk mund të konsiderohet shkelje dhe evidentohet sikur ka përgjegjësi ky komision i përzgjedhur ...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e parashtruara janë përgjithësisht shpjeguese, përsëritëse si dhe të njëjta me observacionet e trajtuara nga grupi i auditimit në Projekt Raportin e Auditimit. Theksojmë sërish se, vetë personat përgjegjës të komisionit janë shprehur që kanë patur nevojë për asistencën e specialistëve të IT-së për identifikimin dhe pranimin e mallit. Gjithashtu, theksojmë se sipas nenit 75, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, thuhet se të paktën një nga anëtarët e KVO duhet të jetë ekspert i fushës. Përsa më sipër, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim për përfshirjen në grupet e KVO të një specialist të Teknologjisë së Informacionit, në rastet kur do të zhvillojë procedura qofshin ato dhe me vlerë të vogël.

Pretendimi i subjektit: ... argumentojmë se shkresat për skualifikimin e operatorit dhe procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është protokolluar nga institucioni, pasi çdo veprim kryhet nëpërmjet sistemit dhe është i verifikueshëm në adresën e APP, duke mos e dhënë mundësinë e qarkullimit të shkresave nëpërmjet protokollit.

... Raporti përmbledhës për këtë rast nuk hartohet nga komisioni por gjenerohet nga sistemi dhe është pjesë e dosjes së procedurës në sistem. Është e pakuptimtë që ky raport siç pretendohet nga ana juaj të dublohet njësoj si raporti që gjenerohet në sistem. E rëndësishme ishte që ky raport i gjeneruar tregon gjithë hapat e ndjekur nëpërmjet sistemit, dhe ku qëndron dallimi apo rëndësia se ky raport duhet formuluar me shkrim kur dispozitat e përcaktojnë që raporti gjenerohet nga sistemi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se, këto observacione janë

të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të bëra për aktkonstatimin e mbajtur, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projekt Raport. Gjithashtu theksojm se, dokumentacioni i plotë nuk gjendej dhe nuk administrohej nga protokollin e AKBN-ës dhe nga ana juaj i është dorëzuar grupit të auditimit përtej afateve të konsiderueshme, megjithatë grupi i auditimit i ka marrë parasysh dhe i ka shqyrtuar. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit

Procedurat e prokurimit që ka kryer AKSHI, ku për periudhën objekt auditimi përfitues është AKBN, janë:

Nr.	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1.	Rinovimi i infrastrukturës qëndrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN	2 muaj implementim	42,972,120
2.	Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN	24 muaj mirëmbajtje	42,464,520

Procedurat e prokurimit që ka kryer AKSHI jashtë periudhës objekt auditimi, por zbatohen në periudhën objekt auditimi 01.01.2021 - 31.12.2023, ku përfitues është AKBN, janë:

Nr.	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1.	Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS	24 muaj mirëmbajtje (2020-2022)	29,440,000
2.	Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë	24 muaj mirëmbajtje (2020-2022)	2,920,000
3.	Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site	2 muaj implementim dhe 48 muaj mirëmbajtje (2020-2024)	52,650,000

Kontrata mirëmbajtjeje viti 2020 të lidhura midis Autoritetit Kontraktor (AKSHI) dhe Kontraktorit me Përfitues AKBN:

Me shkresën nr. 2041/1 prot., datë 27.04.2020, AKBN parashtron kërkesën e saj AKSHI-t, për kryerjen e procedurave të prokurimit për dy shërbimeve në fushën TIK me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë” me fond limit të përlloritur me vlerë 2,950,000 lekë (pa TVSH) për një periudhë dy vjeçare si dhe “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS” me fond limit të përlloritur me vlerë 29,858,774 lekë (pa TVSH) për një periudhë dy vjeçare. Bashkëlidhur shkresës i janë vendosur në dispozicion AKSHI-t përlloraritja e fondit limit dhe specifikimet teknike të kryera nga AKBN. AKBN për këto dy procedura në përlloraritjen e fondit limit ka patur parasysh kontrata paraardhëse të lidhura për të njëjtin

objekt prokurimi.

Me shkresën nr. 2041/10, datë 19.10.2020, AKBN cakton personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave respektivisht si më poshtë:

Znj. E.I përgjegjës për ndjekjen e kontratës me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”;

Z. A.Xh përgjegjës për ndjekjen e kontratës me objekt: “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”.

Personat përgjegjës nga AKSHI për ndjekjen e dy kontratave janë: Znj. A.R dhe z. O.L.

Me shkresën nr. 5465, datë 20.10.2020 AKSHI dërgon për zbatim në AKBN kontratat:

- Kontrata me Nr. Prot., 5301, datë 14.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë” është lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe operatorit “C.)” me vlerë totale 2,920,000 (dy milion e nëntëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH, me një kohëzgjatje prej 24 muajsh mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës.

- Kontrata me Nr. Prot., 5418, datë 19.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS” është lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe operatorit “C.” me vlerë totale 29,440,000 (njëzetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH, me një kohëzgjatje prej 24 muajsh mirëmbajtje nga nënshkrimi i kontratës.

Procedura e prokurimit të këtyre marrëveshjeje shërbimi është hartuar nga AKSHI dhe AKBN ka patur si detyrë ndjekjen e saj.

Më datë 26.10.2020, me shkresën nr. 5595 prot., AKSHI i dërgon Operatorit ekonomik C., kërkesën për ofrim shërbimi mirëmbajtje për kontratën nr. 5418, datë 19.10.2020. AKSHI vendos në dijeni operatorin në lidhje me planifikimin e realizimit të kontratës me objekt “Rinovimi i infrastrukturës Qëndrore të IT (server, storage core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IP për përdoruesit e AKBN”, e cila do të rinovojë pajisjet hardware ekzistuese që mbulohen nga kontrata nr. 5418, datë 19.10.2020, si dhe kërkon dakortësimin për mundësinë e mbulimit me shërbim mirëmbajtje të pajisjeve hardware pa kosto shtesë financiare deri në përfundim të kontratës nr. 5418, datë 19.10.2020. Me shkresën nr. 84 prot., datë 29.10.2020, operatori C. shpreh dakordësinë për realizimin e mirëmbajtjes pa kosto financiare shtesë.

- Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 5301, datë 14.10.2020 për çdo muaj, kontraktuesi ka dorëzuar pranë AKBN “Raportin e mirëmbajtjes së sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë RevZone”. Ky raport tregon të detajuara shërbimet e kryera nga Kontraktuesi në: 1. Përmirësime të sistemit/aplikacionit/modulit, 2. Shërbime të konsulencës; 3. Raporti i problematikave; gjatë një periudhe 1-mujore. Shërbimi i mirëmbajtjes ka vazhduar deri në 20.10.2022.

Nga auditimi u konstatua se, disa fatura dhe raporte mujore nuk janë nënshkruar nga personi ndjekës i kontratës nga AKBN, përkatësisht: fatura dhe raporti i muajit Janar 2021, raporti i muajit Shkurt 2021, raporti dhe fatura e muajit Mars 2021.

Gjithashtu konstatohet se, fatura e muajit Shkurt 2021, Tetor 2021, Janar 2022, Korrik 2022 dhe Qershor 2022 janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës.

- Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 5418, datë 19.10.2020 për çdo muaj, kontraktuesi ka dorëzuar pranë AKBN “Raportin e mirëmbajtjes mujor për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”. Ky raport tregon të detajuara shërbimet e kryera nga

Kontraktuesi në: 1. Mirëmbajtja e sistemit Ersi ArcGIS; 2. Mirëmbajtja e platformës Hardware, Suport për Server, UPS, Tape Library; 3. Suport për pajisjet e rrjetit; 4. Mirëmbajtja për sistemet operative, databazë, etj; 5. Shërbimet e tjera; gjatë një periudhe 1-mujore. Shërbimi i mirëmbajtjes ka vazhduar deri në 19.10.2022.

Nga auditimi u konstatua se, disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Janar 2022, Qershor 2022, Korrik 2022, janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës.

Nga auditimi i këtyre dy procedurave “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë” dhe “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”, u konstatua se personat e ngarkuar për ndjekjen e kontratës nuk kanë hartuar raportin përmbledhës mbi zbatimin e kontratës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 107, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Ngritje e Disaster Recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site

Nisur nga situata e cituar dhe trajtuar në pjesën e “Sigurisë së të dhënave, verifikimit të sigurisë fizike dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit”, referuar zbatimit të VKM-ës nr. 673, datë 22.11.2017, nga AKSHI nuk është administruar asnjë përgjigje për AKBN në lidhje me procesin e kalimit tek AKSHI, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve të përqendruara, AKSHI ofron edhe shërbimin për Data Disaster Recovery (DRC), Vazhdimësinë e Punës (Business Continuity) dhe Ruajtjen e Informacionit (Back-up), në kushtet kur AKBN nuk ka realizuar kalimi tek AKSHI sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, AKBN ka parashikuar zhvillimin e procedurës për ngritjen e infrastrukturës së Disaster Recovery të AKBN-së. Nëse ky shërbim do ofrohej bazuar VKM-ës Nr. 673, datë 22.11.2017 nga AKSHI, ky shpenzim nuk do kryhej nga AKBN.

Procedura është iniciuar që në vitin 2017 dhe është finalizuar në Dhjetor të vitit 2020 kur është lidhur kontrata ku Autoritet Kontraktor është AKSHI, me përfitues AKBN pasi procedura e mëparshme e hedhur në sistemin elektronik është pezulluar për publikim nga APP me shpjegimin se kjo procedurë do të kryhet nga AKSHI, duke ju referuar VKM nr. 673, datë 22.11.2017.

1. Ecuria e zbatimit të kontratës nr. Prot 6963, datë 23.12.2020 me objekt “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site”, është lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI dhe OE “C.” me vlerë totale 52,650,000 (pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Kontrata ka 2 (dy) muaj implementim dhe afat mirëmbajtje 48 muaj, pas implementimit.

- Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN

2. Kontrata me objekt “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN” është lidhur ndërmjet AKSHI-t dhe operatorit “I.” me vlerë totale 42,972,120 (dyzetë e dy milion e

nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH. Kontrata ka 2 (dy) muaj afat lëvrimi nga nënshkrimi i kontratës.

Zhvillimi i procedurave:

Me shkresën nr. 2041/4 prot., datë 14.09.2020, AKBN parashtron kërkesën e saj për kryerjen e procedurave të prokurimit për dy shërbimeve në fushën TIK me objekt:

1. “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN” me vlerë 45,000,000 lekë pa TVSH, i miratuar në Buxhetin e vitit 2020 të AKBN-së nga MIE, dhe:

2. “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site” me vlerë 40,000,000 lekë pa TVSH, i miratuar në Buxhetin e vitit 2020 të AKBN-së nga MIE.

Bashkëlidhur shkresës i janë vendosur në dispozicion AKSHI-t specifikimet teknike të kryera nga AKBN.

AKBN për këto dy procedura paraprakisht ka ngritur urdhrat:

1. Me shkresën nr. 2041/2, datë 28.04.2020, ngrihet komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës për kryerjen e procedurës “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site”, brenda vlerës së parashikuar në buxhetin financiar të vitit 2020 për këtë zë.

- Në zbatim të urdhrit nr. 2041/2, datë 28.04.2020, grupi i punës me shkresën nr. 2041/4, datë 14.09.2020, ka hartuar specifikimet teknike, ndërsa për përllogaritjen e fondit limit me vlerë 40,000,000 lekë (pa TVSH) është bazuar në buxhetin e vitit 2020 të AKBN-ës miratuar nga MIE.

Nga auditimi u konstatua se, grupi i punës nuk ka përllogaritur vlerën e fondit limit për procedurën “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site”, por janë bazuar në vlerën totale të buxhetit të vitit 2020 të AKBN-ës miratuar nga MIE, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 34, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se largësia dhe pozicionimi i site-it DRC sipas specifikimeve teknike të hartuara dhe specifikuara nga AKBN përcaktuar në Datacenterin qeveritar në AKSHI, nuk është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, ku kushtet dhe distancën e ndërtimit të një ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë gjithmonë në një pozicion gjeografik që ka risk shumë të ulët që të përfshihet nga i njëjti incident apo fatkeqësi natyrore nga ambienti primar, minimalisht 50 km distancë në vijë ajore.

2. Me shkresën nr. 2041/3, datë 28.04.2020, ngrihet komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës për kryerjen e procedurës “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, brenda vlerës së parashikuar në buxhetin financiar të vitit 2020 për këtë zë.

- Në zbatim të urdhrit nr. 2041/3, datë 28.04.2020, grupi i punës me shkresën nr. 2041/4, datë 14.09.2020, ka hartuar specifikimet teknike, ndërsa për përllogaritjen e fondit limit me vlerë 45,000,000 lekë (pa TVSH) është bazuar në buxhetin e vitit 2020 të AKBN-ës miratuar nga MIE.

Nga auditimi u konstatua se, grupi i punës nuk ka përllogaritur vlerën e fondit limit për

procedurën “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, por janë bazuar në vlerën totale të buxhetit të vitit 2020 të AKBN-ës miratuar nga MIE, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 34, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Me shkresën nr. 4482/1, datë 21.09.2020, AKSHI kërkon nga AKBN të vendosë në dispozicion nga 1 (një) përfaqësues me qëllim ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës kryerjen e studimit të tregut dhe hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim.

- Me shkresën nr. 2041/8, datë 24.09.2020 AKBN cakton personat përgjegjës për hartimin e termave të referencës kryerjen e studimit të tregut dhe hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, si më poshtë:

Z. A.Xh përgjegjës për procedurën: “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”;

Znj. E.I përgjegjës për procedurën: “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”.

Me anë të email, AKSHI vendos në dijeni ngritjen e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlogaritjen e vlerës limit të kontratës.

1. Për procedurën “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”, personat përgjegjës nga AKSHI janë: Znj. A.R dhe z. O.L.

Grupi i punës i ngritur nga AKBN dhe AKSHI ka hartuar specifikimet teknike, kriteret e veçanta dhe përlogaritjen e fondit limit me vlerë 55,184,442 lekë (pa TVSH). Vlera e implementimit është 39,199,686 lekë (pa TVSH) dhe vlera e mirëmbajtjes është 15,984,756 lekë (pa TVSH).

- **Nga auditimi u konstatua se**, vlera e kontratës 52,650,000 lekë (pa TVSH) është 24% më e lartë se fondi që AKBN ka përlogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020 në MIE e cila është 40,000,000 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit nuk ka administruar asnjë dokumentacion ndërmjet AKBN dhe AKSHI-it në lidhje me ndryshimin e përlogaritjes së fondit limit me fondin që AKBN ka përlogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020, si dhe nuk është marrë dakordësia nga AKBN për rritjen e fondit limit në vlerën 12,650,000 lekë.

- Nga auditimi u konstatua se AKBN dhe AKSHI nuk kanë dakordësuar me një shkresë zyrtare për hostimin e infrastrukturës së DRC në Datacenterin qeveritar në AKSHI.

- Nga auditimi u konstatua se largësia dhe pozicionimi i site-it DRC sipas nenit 4 të Kushteve të veçanta të kontratës Nr. Prot 6963, datë 23.12.2020, përcaktohet se shërbimet do të kryhen sipas përcaktimeve në ofertën teknik, ku sipas përcaktimeve në ofertën teknike bashkëlidhur kontratës rezulton se vendodhja është përcaktuar përsëri në Datacenterin qeveritar në AKSHI, e cila nuk është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

- Nga auditimi u konstatua se nga AKBN nuk janë kryer asnjëherë testime për Disaster Recovery Site mbi funksionalitetet e tij në rast se do të ndodhnin evente me pasoja negative (rresiqe natyrore, katastrofa etj) në AKBN, duke sjellë risk të lartë në ndërprerje të shërbimeve dhe kohë të pacaktuar për rikthimin e shërbimeve dhe të dhënave në funksionalitet të plotë.

2. Për procedurën “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, personat përgjegjës nga AKSHI janë: Znj. A.R dhe z. O.L.

- Me shkresën nr. 2041/14, datë 21.12.2020 AKBN cakton personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave respektivisht si më poshtë:

Z. A.Xh përgjegjës për ndjekjen e kontratës me objekt: “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site”;

Znj. E.I përgjegjës për ndjekjen e kontratës me objekt: “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”.

Gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit nuk ka administruar për një kohë të gjatë asnjë dokumentacion nëpërmjet AKBN dhe AKSHI në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e vlerës limit dhe hartimin e termave të referencës, referuar dhe urdhërave përkatës të ngritur nga dy institucionet.

Nga dokumentacioni i kërkuar dhe komunikimet me email në lidhje me vendosjen në dispozicion të grupit të auditimit nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e vlerës limit dhe hartimin e termave të referencës, AKBN i parashtron kërkesën AKSH-it me shkresën nr. 1977/2, datë 22.05.2024 për vënien në dispozicion të shkresave përsa është kërkuar nga grupi i auditimit. Nga AKSHI nuk është kthyer asnjë përgjigje, nisur nga ky fakt AKBN me shkresën nr. 1977/3, datë 04.07.2024 autorizon një punonjës për të tërhequr materialet përsa janë kërkuar nga grupi i auditimit. Materiale i janë vendosur në dispozicion nga AKSHI dhe janë protokolluar në AKBN me shkresën nr. 1977/4, datë 05.07.2024.

Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni i këtyre shkresave i është vendosur në dispozicion AKBN-ës pas 4 vitesh nga AKSHI.

Zbatimi i kontratës:

1. Ngritje e Disaster Recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site

Me shkresën nr. 6972, datë 23.12.2020 AKSHI dërgon për zbatim në AKBN kontratën:

- Kontrata me Nr. Prot 6963 lidhur në datën 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”.

- Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020, vlera e implementimit të kontratës është 37,578,000 (tridhjetë e shtatë milion e pesëqindt e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë pa tvsh dhe vlera e mirëmbajtjes është 15,072,000 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh. Zbatimi i kontratës vazhdojë për 2 (dy) muaj implementim dhe 48 (dyzetë e tetë) muaj mirëmbajtje.

Qëllimi i projektit është zgjerimi i infrastrukturës (server/storage/network) në një site dytësor për të garantuar backup të vazhdueshëm dhe mundësi për të rikthyer shërbimet dhe të dhënat në funksionalitet të plotë në një kohë sa më të shkurtër në rast problemesh madhore.

Vendodhja e shërbimeve sipas kontratës së sipërcituar është në Datacenterin Qeveritar, pranë AKSHI-t.

Me shkresën nr. 281, datë 15.01.2021, protokolluar në AKBN, OE ka dërguar Raportin Fillestar të Implementimit të Projektit, sipas kontratës nr. Prot 6963, datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”. Ky raport përmbanë analizën e situatës aktuale të infrastrukturës qendrore të IT të ngritur në godinën qendrore të AKBN. Gjithashtu specifikohet dhe plani i punës me afatet kohore përkatëse.

Në datën 02.02.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës

nr. Prot., 6963, datë 23.12.2020 ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (C.).

Praktika me nr. 646 prot., datë 02.02.2021, Akt-Dorëzimi jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	Switch-HPE 5710 24SFP+6QS+/2QS28 Switch	2	8,000,000
2.	Server për Aplikim - HPE DL260 Gen 10 CTO Server	2	8,000,000
3.	Server për Aplikim dhe Backup – HPE DL360 Gen 10 CTO Server	1	4,150,000
4	Storage – IBM Flash System 5100	1	5,500,000
	Vlera pa TVSH		25,650,000
	Vlera me TVSH		30,780,000

Bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Fatura e fiskalizuar me datë 02.02.2021 nga OE, si dhe fleta e garancisë së pajisjeve.

Me shkresën nr. 646/1, datë 02.02.2021 është mbajtur Akt marrja në dorëzim, në prani të AK (AKSHI),OE dhe Autoritetit Përfitues (AKBN). Ndjekësit e kontratës kanë verifikuar, se dokumentat dhe sistemi janë në përputhje me zgjidhjen teknike në kontratën e sipërcituar. Bashkëlidhur këtij akt marrje në dorëzim janë:

Akt Dorëzimi, nr. 646, datë 02.02.2021, faturë e fiskalizuar datë 02.02.2021 dhe garancia e pajisjeve.

Me shkresën nr. 646/2, datë 05.02.2021 AKSHI i vendos në dispozicion AKBN-ës dokumentacionet për zbatimin e kontratë nr. 6963, datë 23.12.2020, bashkëlidhur kësaj shkrese dhe dokumentacionin si më poshtë:

Faturë e fiskalizuar datë 02.02.2021, Akt Dorëzimi, nr. 646, datë 02.02.2021, Akt marrje në dorëzim nr. 646/1, datë 02.02.2021.

Me anë të shkresës nr. 281/36 datë 23.02.2021 është mbajtur proces-verbal i pjesshëm i mallrave nga personi i autorizuar nga AKBN për ndjekjen e kontratës, i cili ka konfirmuar pranimin e mallrave në përputhje me kontratën si dhe procedimin me magazinimin e mallrave dhe kryerjen e pagesës.

- Në datën 19.02.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës nr. Prot., 6963, dtaë 23.12.2020 ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (C.).

Praktika me nr. 1093 prot., datë 19.02.2021, Akt-Dorëzimi jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	Backup Disk to Disk – HPE StoreOnce 3620	1	3,650,000
2.	Backup to Tape – HPE StoreEver MSL2024	1	3,166,000
3.	Kaseta për Tape Librarianë – HPE LTO-7 15TB RW Data Cartridge	24	720,000
4	Backup Software – Veem Backup & Replication	1	4,017,000
	Vlera pa TVSH		11,553,000
	Vlera me TVSH		13,863,600

Bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Fatura e fiskalizuar me datë 19.02.2021 nga OE, si dhe fleta e garancisë së pajisjeve.

Me shkresën nr. 1093/1, datë 19.02.2021 është mbajtur Akt marrja në dorëzim, në prani të AK (AKSHI), OE dhe Autoritetit Përfitues (AKBN). Ndjekësit e kontratës kanë verifikuar, se dokumentat dhe sistemi janë në përputhje me zgjidhjen teknike në kontratën e sipërcituar. Bashkëlidhur këtij akt marrje në dorëzim janë:

Akt Dorëzimi, nr. 1093, datë 19.02.2021, faturë e fiskalizuar datë 19.02.2021 dhe garancia e pajisjeve.

- Në datën 26.02.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës nr. Prot., 6963, datë 23.12.2020. ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (C.).

- Me shkresën nr. 1093/2, datë 23.02.2021 protokolluar në AKSHI, dorëzohet në AKBN, Raporti Final i Implementimit të Projektit nga OE, sipas kontratës nr. Prot 6963, datë 23.12.2020. Ky raport përshkruan në detaje infrastrukturën qendrore të IT të instaluar dhe konfiguruar në Datacenter-in e AKSHI. Përshkruhen raporti i instalimit, konfigurimet e pajisjeve, lidhja me serverat, konfigurimi i infrastrukturës Backup etj.

Praktika me nr. 1093/4 prot., datë 26.02.2021, Akt-Dorëzimi jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	Implementimi i plotë i zgjidhjes në DR Site	1	125,000
2.	Trajnime	5	250,000
	Vlera pa TVSH		375,000
	Vlera me TVSH		450,000

Bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Fatura e fiskalizuar me datë 26.02.2021 nga OE, si dhe programi i trajnimeve.

Me shkresën nr. 1093/5, datë 26.02.2021 është mbajtur Akt marrja në dorëzim, në prani të AK (AKSHI), OE dhe Autoritetit Përfitues (AKBN). Ndjekësit e kontratës kanë verifikuar, se dokumentat dhe sistemi janë në përputhje me zgjidhjen teknike në kontratën e sipërcituar. Bashkëlidhur këtij akt marrje në dorëzim janë:

Akt Dorëzimi, nr. 1093/4, datë 26.02.2021 dhe faturë e fiskalizuar datë 26.02.2021.

Në zbatim të kontratës dhe zërit numër 10 të Formularit të Deklarimit të Ofertës (Trajnime) është zhvilluar trajnimi i personelit lidhur me sistemet e reja të AKBN në DR Site përgjat periudhës 16.02.2021 – 22.02.2021.

Si pjesë e kushteve të veçanta të Kontratës, neni 6 “Kërkesat e Raportimit” citohet se: “Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raportime për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Raportet do të dërgohen sipas përcaktimeve të Ofertës Teknike bashkëlidhur kontratës”. Sipas pikës 6 “Raportimi” në Ofertën Teknike, Kërkesat e Raportimit janë:

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip në origjinal në 3 kopje:

- Raportin Fillestar, brenda 2 (dy) javësh nga fillimi i implementimit;
- Draft i raportit përfundimtar, jo më vonë se dy (dy) javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave;
- Raporti final, afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është një javë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me Faturën përfundimtare.

Nga auditimi sipas raportimeve periodike u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar Draft i raportit përfundimtar nga personat ndjekës të kontratës. Kjo në kundërshtim me pikën 6 të Kushteve të Veçanta të Kontratës.

Gjithashtu nga auditimi i procedurës “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site” për AKBN, u konstatua se, Autoriteti Kontraktor (AKSHI) nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zbatimit të kontratës me operatorin ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Sqarojmë se afati i fundit i zbatimit të kësaj kontrate është data 23.02.2025 dhe objekti i punës audituese të Grupit të Punës është deri në datën 31.12.2023. Pavarësisht sa më sipër, ne si grup auditimi kemi disponuar, shqyrtuar dhe audituar zbatimin e kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020, deri në periudhën 31.12.2023. Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020 për çdo muaj deri në datën 31.12.2023, kontraktuesi ka dorëzuar pranë AKBN “Raportin e mirëmbajtjes mujore për kontratën nr. Prot 6963, datë 23.12.2020 “Ngritja e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”. Ky raport tregon të detajuara shërbimet e kryera nga Kontraktuesi në: 1. Raportimin Javor për: 1.1 Kontrolli i log-eve të paisjeve fizike; 1.2 Kontrolli i statistikave të hapsirave fizike storage, 1.4 Kontrolli i statistikave, 1.4 Kontrolli i pajisjeve për probleme, 1.5 Të kryej mirëmbajtje proaktive (mirëmbajtje parandaluese dhe parashikuese për makinat dhe paisjet, 1.6 Kontrolli i funksionalitetit të sistemit; 2. Raportimet mujore për: 2.1 Testim kontrolli i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit, 2.2 Kontrolli i detajuar i gjithë log-eve hardware/software, 2.3 Rishikimi i të dhënave mbi performancën e serverave, 2.4 Rekomandime për upgrade të mundshme hardware, 2.5 Kontrolli i funksionaliteteve të sistemit; gjatë një periudhe 1-mujore. Shërbimi i mirëmbajtjes për këtë procedurë vazhdon deri në 23.02.2025.

Nga auditimi u konstatua se, disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Janar 2022, Qershor 2022, Korrik 2022, Gusht 2022, janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.3, të nenit 8 të Kontratës.

Zbatimi i kontratës:

2. Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core netëork) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN

Me shkresën nr. 112, datë 08.01.2021 AKSHI dërgon për zbatim në AKBN kontratën:

- Kontrata me Nr. Prot 44 lidhur në datën 06.01.2021 “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”.

- Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020, vlera totale e kontratës është 42,972,120 (dyzetë e dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH. Kontrata ka 2 (dy) muaj afat lëvrimi nga nënshkrimi i kontratës.

Objekti i kontratës është rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Vendodhja e shërbimeve sipas kontratës së sipërcituar është në zyrat qendrore të AKBN.

Me shkresën nr. 182/2, datë 09.02.2021, protokolluar në AKBN, AKSHI ka dërguar Raportin Fillestar nga Kontraktuesi, I., sipas kontratës nr. Prot 44 datë, 06.01.2021 “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”. Ky raport përmbanë analizën e situatës aktuale të infrastrukturës qendrore të IT të ngritur në godinën qendrore të AKBN. Në këtë raport cilësohen zgjidhjet e propozuara mbi instalimin e pajisjeve të reja, lidhjen me infrastrukturën e TI në godinën qendrore dhe integrimin në këtë infrastrukturë. Gjithashtu specifikohet plani i punës së implementimit të projektit së bashku me afatet kohore

përkatëse. Në datën 20.01.2021 është mbajtur Proces-verbali nga përfaqësuesit e grupit të punës në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës së sipërcituar, për nënshkrimin e Raportit Fillestar me Nr. 27 Prot., datë 20.01.2021, protokolluar nga OE.

Nga auditimi u konstatua se, Raporti fillestar i Implementimit si dhe procesverbali i dorëzimit të tij nuk është firmosur nga personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës nga AKBN znj. E.I.

Në datën 10.02.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës nr. Prot., 44 datë, 06.01.2021 ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Ktraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (I.).

Praktika më datë 10.02.2021, Akt-Dorëzimi jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	Switch-HPE 5710 24SFP+6QSFP+/2QSFP28 Switch	2	5,369,000
2.	Sistem NAC Aruba ClearPass NL AC 500 CE E- LTO Aruba ClearPass NL OB 100 USR E- LTO	1	2,707,500
3.	Access Point WiFi Aruba AP – 303 (RW) Unifiet AP	40	2,211,600
4.	Switch Aksesit/ Agregimi Aruba 2930F 48G PoE+4SFP+ Switch	6	5,156,520
5.	Shasi për Server Blade HPE SYNERGY 12000	1	5,859,000
6.	Server HPE SYNERGY 480 GEN10	4	7,440,000
7.	Storage IBM FlashSystem 5100	1	3,196,000
8.	UPS HPE G2 R600/60309 3- Wire 32A/230V Outles (4) C13 (4) C19 (1) IEC 32A/3U Rackmount Intl UPS	2	1,372,000
Vlera pa TVSH			33,311,620
Vlera me TVSH			39,973,944

Bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Fatura e fiskalizuar me datë 10.02.2021 nga OE, fleta e garancisë, certifikata e cilësisë, certifikatat e origjinës, data-sheets.

Me shkresën nr. 852/1, datë 10.02.2021 është mbajtur Akt marrja në dorëzim, në prani të AK (AKSHI), OE dhe Autoritetit Përfitues (AKBN). Ndjekësit e kontratës kanë verifikuar, se dokumentat dhe sistemi janë në përputhje me specifikimet teknike në kontratën e sipërcituar.

- Në datën 25.02.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës nr. Prot., 44 datë, 06.01.2021 ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Ktraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (I.).

Praktika më nr. 1223 datë 10.02.2021 (protokolluar në AKSHI), Akt-Dorëzimi jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	NGFW VPN Barracuda CloudGen Firewall F400 F20	2	5,460,000
2.	Load Balancer Barracuda Load Balancer ADC 540	2	2,880,000
3.	Mail Security Barracuda Email Security Gateway Vx V300	1	588,000
Vlera pa TVSH			8,928,000
Vlera me TVSH			10,713,600

Bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Fatura e fiskalizuar me datë 25.02.2021 nga OE, fleta e garancisë, certifikata e cilësisë, certifikatat e origjinës, data-sheets.

Me shkresën nr. 1223/1, datë 25.02.2021 është mbajtur Akt marrja në dorëzim, në prani të AK (AKSHI), OE dhe Autoritetit Përfitues (AKBN). Ndjekësit e kontratës kanë verifikuar, se dokumentat dhe sistemi janë në përputhje me specifikimet teknike në kontratën e sipërcituar.

Me anë të shkresës nr. 182/4 datë 26.03.2021 është mbajtur proces-verbal i pjesshëm i mallrave nga personi i autorizuar nga AKBN për ndjekjen e kontratës, i cili ka konfirmuar pranimin e mallrave në përputhje me kontratën si dhe procedimin me magazinimin e mallrave dhe kryerjen e pagesës.

- Me shkresën nr. 1432/1, datë 05.03.2021 është mbajtur proces-verbali mbi dorëzimin e mallrave sipas kontratës nr. Prot., 44 datë, 06.01.2021 ndërmjet personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI), Autoriteti Përfaqësues (AKBN) dhe Kontraktuesi (I.).

Akt marrja në dorëzimi më datë 05.03.2021 jep informacionin lidhur me dorëzimin e artikujve të kontratës si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1.	Instalim, konfigurim të pajisjeve	1	490,000
2.	Trajnimi i përdoruesve	5	242,500
	Vlera pa TVSH		732,500
	Vlera me TVSH		879,000

Gjithashtu bashkëlidhur kësaj praktike është vënë në dispozicion Raporti Final i Instalimeve dhe Konfigurimeve në 4 (-kopje), dokumentacioni i trajnimeve dhe fatura e fiskalizuar me datë 05.03.2021 nga OE.

Raporti Final i Implementimit të Projektit nga OE, sipas kontratës nr. Prot 44 datë, 06.01.2021. Ky raport përshkruan të dhëna mbi instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të reja, lidhjen e tyre me infrastrukturën TI në godinën qendrore dhe integrimin në këtë infrastrukturë; Ngritja e shërbimeve cluster Microsoft Failover Cluster; Migrimi i makinave virtuale; Virtualizimi i storage ekzistues në një storage të ri; Instalimet dhe konfigurimet për infrastrukturën Netowrk dhe Sigurinë etj.

Në zbatim të kontratës dhe zërit numër 13 të Formularit të Deklarimit të Ofertës (Trajnimi i përdoruesve) është zhvilluar trajnimi i personelit lidhur me rinovimin e infrastrukturës qendrore të IT (server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN 26.02.21 – 04.05.2021.

Me anë të shkresës nr. 182/6 datë 01.04.2021 është mbajtur proces-verbal i pjesshëm i mallrave nga personi i autorizuar nga AKBN për ndjekjen e kontratës, i cili ka konfirmuar pranimin e shërbimeve në përputhje me kontratën si dhe procedimin më tej me kryerjen e pagesës.

Nga auditimi u konstatua se, Raporti Final i Implementimit të Projektit nuk është firmosur nga personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës nga AKBN znj. E.I, si dhe një nga anëtarët të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI) përkatësisht z. O.L.

Nga auditimi i procedurës “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, u konstatua se Autoriteti Kontraktor (AKSHI) nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zbatimit të kontratës me operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Gjithashtu u konstatua se, personat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës nuk kanë hartuar raportin përmbledhës mbi zbatimin e kontratës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 107, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN

Kontrat mirëmbajtjeje viti 2023 lidhur midis Autoritetit Kontraktor (AKSHI) dhe Kontraktorit me Përfitues AKBN:

Me shkresën nr. 3817/3 prot., datë 26.09.2022, AKBN parashton kërkesën e saj AKSHI-t për kryerjen e procedurave të prokurimit për dy shërbimeve në fushën TIK me objekt:

- “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”, me vlerë limit 42,000,000 lekë pa TVSH, të llogaritur nga studimi i tregut, për një periudhë dy vjeçare.

- “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”, me vlerë limit 2,920,000 lekë pa TVSH, të llogaritur duke u referuar në kontratën paraardhëse, për një periudhë dy vjeçare.

Bashkëlidhur shkresës i janë vendosur në dispozicion AKSHI-t specifikimet teknike të kryera nga AKBN.

Me shkresën nr. 3817/4, datë 07.10.2022, protokolluar në AKBN, AKSHI i drejtohet AKBN-ës për vendosjen në dispozicion përfaqësuesit për ndjekjen e procedurave të sipërcituara.

Me shkresën nr. 3817/5, datë 11.10.2022, AKBN cakton përfaqësuesit për ndjekjen e procedurave respektivisht si më poshtë:

Znj. E.I përfaqësues për ndjekjen e procedurës me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”;

Z. A.Xh përfaqësues për ndjekjen e procedurës me objekt: “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”.

- Me shkresën nr. 6544 prot., datë 19.10.2022, protokolluar në AKBN me nr. 3848/2 datë 24.10.2022, AKSHI i drejtohet AKBN-ës për caktim e përfaqësuesit për vijimin mëtejshëm për procedurat e sipërcituara, gjithashtu e informon AKBN-ën, se do procedojë për vijimin e mirëmbajtjes së kontratave të sipërcituara duke i bashkuar në një të vetme me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”.

- Me shkresën nr. 3848/3, datë 24.10.2022, AKBN bënë me dije AKSHI-n se janë njoftuar për bashkimin e kontratave të sistemeve të IT në një të vetme dhe e informon AKSHI-in në lidhje me planifikimin dhe miratimin në MIE buxhetin e vitit 2022, ku sistemet janë të ndara në kontrata të veçante dhe për rrjedhim faturimi i shërbimeve ka qenë i ndarë. Gjithashtu vendos në dijëni AKSHI-n, pasi të firmoset kontrata e re të kihet parasysh që deri në përfundt të vitit 2022 fatura të jetë e ndarë në dy nënzëra me vlerat përkatëse me qëllim njohjen e detyrimit dhe kryerjen e pagesës sipas buxhetit të miratuar. Në rast se faturimi i shërbimeve nuk do të jetë i detajuar, AKBN do të mbartë këto detyrime në buxhetin e vitit 2023, ku do të hartohet fondi në një zë të vetëm dhe përcakton personat përgjegjës për institucionin me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave, përkatësisht: Znj. E.I dhe z. A.Xh.

- Me shkresën nr. 5170, datë 16.12.2022, AKBN i i dërgon informacion AKSHI-t mbi problematikat e shfaqura nga mosrealizimi në kohë i kontratës së suportit për sistemet TIK në AKBN. Gjithashtu e informon se kjo situat kërkon nevojën emergjente të realizimit të kontratës së suportit për sistemet TIK.

- Me shkresën nr. 7933/1, datë 21.12.2022, AKSHI vendos në dijëni AKBN në lidhje me vijimin e procedurës, dhe me shkresën nr. 689, datë 03.02.2023, AKSHI informon AKBN se ka finalizuar procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”, si dhe kërkon nga AKBN të vendosë në dispozicion personat e autorizuar për ndjekjen e kontratës.

- Me shkresën nr. 9571/1, datë 10.02.2023, AKBN cakton personat përfaqësues të ndjekjes së kontratës: Znj. E.I, z. A.Xh dhe znj. E.Ç.

Me shkresën nr. 942, datë 16.02.2023 AKSHI dërgon për zbatim në AKBN kontratën:

- Kontrata me Nr. Prot 49 lidhur në datën 15.02.2023 “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”, protokolluar me nr. 957/2, datë 20.02.2023 në AKBN.

- Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 49 datë 15.02.2023, vlera totale e kontratës është 42,464,520 (dyzetë e dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pseë qindë e njëzet) lekë pa tvsh. Zbatimi i kontratës për 24 (njëzetë e katër) muaj mirëmbajtje nga data e nënshkrimit të saj.

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shkërbimit për mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të informacionit në AKBN.

Me anë të urdhrin nr. 49/1, datë 15.02.2023 protokolluar në AKSHI, pasi është nënshkruar kontrata ndërmjet Autoritetit Kontraktor (AKSHI) dhe OE (C.), nga AKSHI ngarkohen me detyrë ndjeksit për kontratën nr. 49 datë 15.02.2023: znj. A.R dhe z. O.L.

Sqarojmë se afati i fundit i zbatimit të kësaj kontrate është data 15.02.2025 dhe objekti i punës audituese të Grupit të Punës është deri në datën 31.12.2023. Pavarësisht sa më sipër, ne si grup auditimi kemi disponuar, shqyrtuar dhe audituar zbatimin e kontratës nr. 49 datë 15.02.2023, deri në periudhën 31.12.2023. Në vijim të zbatimit të kontratës nr. 49 datë 15.02.2023, për çdo muaj deri në datën 31.12.2023, kontraktuesi ka dorëzuar pranë AKBN “Raportin e mirëmbajtjes mujore të mirëmbajtjes e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”. Ky raport tregon të detajuara shërbimet e kryera nga Kontraktuesi në: 1. Mirëmbajtja e Sistemit Revzone, duke përfshirë: përditësime, përmirësime, apo Modifikim të aplikacionit apo infrastrukturës; 2. Shërbime të konsulencës, raport të problematikave; 3. Mirëmbajtja e sistemit GIS, duke përdshirë mirëmbajtjen e software Esri ArcGis, Web-GIS; 3. Mirëmbajtja e platformës Hardware, 4. Mirëmbajtja për sistemet Operative, Databazë, etj, si dhe shërbime të tjera, gjatë një periudhe 1-mujore. Shërbimi i mirëmbajtjes për këtë procedurë vazhdon deri në 16.02.2025.

Nga auditimi u konstatua se, disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Gusht 2023 (për periudhën e shërbimit Korrik-Gusht), Nëntor 2023 (për periudhën e shërbimit Tetor-Nëntor), janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr. 49 datë 15.02.2023, u konstatua se AKBN-ës nuk i janë vendosur në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI) Termat e referencës – Specifikimet teknike, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, të nenit 13 të Kontratës.

Nga auditimi u konstatua se, me përfundimin e kontratave të mirëmbajtjes përkatësisht: më datë 14.10.2022 ka përfunduar kontrata me Nr. Prot., 5301, datë 14.10.2020 “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë” dhe më datë 19.10.2022 ka përfunduar kontrata me Nr. Prot., 5418, datë 19.10.2020 “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”, sistemet dhe infrastruktura qendrore IT e AKBN deri në lidhjen e kontratës së re më datë 15.02.2023, kanë qenë për një periudhë kohore rreth 5 muaj në pamundësi të vijimit në normalitet me proceset e punës së institucionit. Kjo situat në rast përsëritje sjell riskun e mundësisë për ndërprerjen e shërbimeve dhe pamundësinë për rikthimin në gjendjen fillestare të sistemeve duke ndikuar në procesin e punës të AKBN-ës.

<p>Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti AKSHI është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3723/1 prot., datë 29.08.2024 “Dërgim observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë: <u>Pretendimi i subjektit:</u> ... Për kontratën nr. 5301 prot., datë 14.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”, faturat</p>
--

e muajit shkurt 2021, tetor 2021, janar 2022 dhe korrik 2022, janë dorëzuar brenda afatit ligjor 30 ditor, ndërkohë fatura e muajit qershor 2022 nuk është dorëzuar në kohë për shkak të sulmit kibernetik të ndodhur në datën 15 korrik 2022.

Për kontratën nr. 5418 Prot., datë 19.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS” faturat e muajit janar dhe korrik 2022 janë dorëzuar brenda afatit ligjor 30 ditor, ndërkohë fatura e muajit qershor 2022 nuk është dorëzuar në kohë për shkak të sulmit kibernetik të ndodhur në datën 15 Korrik 2022.

Për kontratën nr. 49 Prot, datë 15.02.2023 “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”, faturat e muajit gusht dhe nëntor 2023 janë ndjekur nga ndjekësit e AKSHI-t dhe janë aprovuar brenda afatit ligjor 30 ditor por nënshkrimi i tyre për faturën e muajit gusht 2023 është vonuar për shkak të ndjekësit të caktuar nga AKBN-ja në cilësinë e institucionit përfitues.

Për kontratën nr. 6963 Prot., datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site”, faturat e muajit janar 2022, korrik 2022 dhe gusht 2022 janë dorëzuar brenda afatit ligjor 30 ditor, ndërkohë fatura e muajit qershor 2022 nuk është dorëzuar në kohë për shkak të sulmit kibernetik të ndodhur në datën 15 Korrik 2022.

... Për kontratën nr. 5301, datë 14.10.2020 dhe kontratën nr. 44, datë 06.01.2021 bashkëlidhur do të gjeni raportin përmbledhës të hartuar nga KVO-ja për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave. Për kontratën nr. 49, datë 15.02.2023, termat e referencës dhe specifikimet teknike janë pjesë përbërëse e Kontratës...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e parashtruara janë përgjithësisht shpjeguese, pasi janë trajtuar dhe diskutuar gjatë fazës së terrenit me personat ndjekës të kontratave respektive nga AKBN, si dhe nuk ndryshojnë konstatimet e grupi të auditimit. Theksojm se, grupi i auditimit nuk është shprehur në lidhje me çfarë ju pretendoni dhe observoni, grupi i auditimit i referohet dorëzimit të faturave me qëllim likuidimin e tyre jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave të caktuar nga AKBN. Gjithashtu, përsa i përket kontratës nr. 5301, datë 14.10.2020 dhe kontratës nr. 44, datë 06.01.2021 grupi i auditimit nuk është shprehur në asnjë moment për raportin përmbledhës të hartuar nga KVO-ja për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave, por për raportet përmbledhës mbi zbatimin e kontratave të sipërcituara, të cilat duhet të ishin hartuar nga personat e ngarkuar për ndjekjen e kontratës, në përputhje me përcaktimet ligjore në nenin 107, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: ... në kërkesën për nisjen e procedurës të dërguar nga AKBN me shkresën nr. 2041/4, datë 14.09.2020 përcaktohet fondi i parashikuar në buxhetin e AKBN-së për implementimin e sistemit të kërkuar në vlerën 40,000,000 lekë (pa tvsh), vlerë kjo e parashikuar nga AKBN-ja në buxhetin e vitit 2020. AKSHI në zbatim të nenit 35, 36 të Ligjit nr. 162/2020 ka ngritur grupin e punës me Urdhërin Nr. 298, datë 01.10.2020 për hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, pasi kontrata e prokuruar për projektin me objekt “Ngritjen e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary site-disaster recovery site”, ka implementim 2 muaj dhe mirëmbajtje 48 muaj, kjo në zbatim të VKM-së nr. 710/2013 duke qenë se po ngrihej një sistem i ri.

Pra, grupi i punës me përfaqësues dhe nga AKBN-ja është ngritur me urdhër të AKSHI-t në

cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe jo nga AKBN-ja sikundër pretendohet në gjetjet e grupit të auditimit. Nga përlllogaritja rezulton se vlera e fondit limit është 55,184,442 lekë (pa TVSH), ku: 39,199,686 është vlera e implementimit të sistemit; 15,984.756 është vlera e mirëmbajtjes.

Ndodhemi përpara faktit që, nuk është tejkualuar asnjë vlerë, pasi fondi që AKBN-ja ka parashikuar ka qenë për implementimin e sistemit, ndërkohë në përlllogaritjen e fondit kemi vlerën e implementimit dhe vlerën e mirëmbajtjes së bashku.

Pra, nuk kemi të bëjmë me ndryshimin e përlllogaritjes së fondit limit sikundër pretendon grup i auditimit, pasi AKBN-ja nuk ka të drejtë të kryej përlllogaritjen e fondit limit, kjo është një detyrë që kryhet nga AKSHI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Sjellim në vemëndjen tuaj se, vlera financiare e parashikuar për implementimin e sistemit në buxhet nga AKBN-ja, me vlerën e përlllogaritjes së fondit limit të kontratës së shërbimit, janë tërësisht të ndryshme dhe përlllogaritja e tyre kryhet në zbatim të akteve ligjore respektive... Në përfundim të implementimit të sistemit janë kryer dhe testimet e parashikuara në termat e referencës dhe kanë rezultuar të suksesshme. Testimi është shoqëruar me një raport, i cili i është bashkëlidhur raportit përfundimtar të marrjes në dorëzim të implementimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e parashtruara janë në tërësi shpjeguese, si dhe janë përsëritje të një pjese të konsiderueshme të konstatimeve nga grupi i auditimit. Ju rikujtojmë se gjatë fazës së terrenit grupi i auditimit nuk ka administruar për një kohë të gjatë asnjë dokumentacion nëpërmjet AKBN dhe AKSHI në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e vlerës limit dhe hartimin e termave të referencës, referuar dhe urdhërave përkatës për të cilat ju observoni, dokumenta të cilat duhet të administronte dhe AKBN, jo vetëm të administroheshin nga ju. Gjithashtu për kontratën nr. 49, datë 15.02.2023, AKBN nuk disponon asnjë kopje të termave të referencës dhe specifikimeve teknike të hartuar nga grupi i punës, ku një nga anëtarët është personi përgjegjës i caktuar nga AKBN.

Përsa i përket faktit që ju pretendoni se nuk është tejkualuar asnjë vlerë, pasi fondi që AKBN-ja ka parashikuar ka qenë për implementimin e sistemit, ndërkohë në përlllogaritjen e fondit kemi vlerën e implementimit dhe vlerën e mirëmbajtjes së bashku, sqarojmë sërish se grupit të auditimit sërish nuk i është vendosur në dispozicion as nga AKBN dhe as nga ju dokumentacion mbi dakordësin nga AKBN për rritjen e fondit limit në vlerën 12,650,000 lekë, pasi fondi që AKBN ka miratuar në Buxhetin e vitit 2020 në MIE.

Gjithashtu dhe nga dokumentacioni i vendosur nga ana juaj me shkresën nr. 1977/4, datë 05.07.2024 protokolluar në AKBN, nuk administrohej asnjë dokumentacion ku tju ketë vënë ju në djeni në lidhje me konfirmimin për disponibilitetin e total fondit limit dhe në rast se do mundësojë dhe do të miratojë pjesën tjetër të mbetur në projekt-buxhetin e vitit pasardhës, për të qenë disponibël në realizimin e procedurës.

Përsa i përket testimit për Disaster Recovery Site mbi funksionalitetet e tij, grupit të auditimit nuk i është vendosur asnjë dokumentacion justifikues në rast se janë mbajtur procesverbale testimi sesi do ngrihej Site Sekodar në rast se në Site-in Primar në AKBN do të ndodhnin evente me pasoja negative (rresiqe natyrore, katastrofa etj) ku të testohesh dhe qëllimi për të cilën është investuar. Përsa më sipër konstatimet e grupit të auditimit nuk ndryshojnë.

2.3 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në AKBN;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- Aksesimi i sistemit me përdorues me të drejta “lexues”;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet;
- Informacion mbi veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manuallet e përdorimit të sistemeve;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika, etj.

➤ *Sistemi për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore të Republikës së Shqipërisë – RevZone (Lejet minerare)*

Sistemi RevZone, është një sistem modular elektronik i instaluar dhe funksional në AKBN. Sistemi bënë administrimin dhe menaxhimin e proceseve të punës në AKBN, si dhe të marrëdhënieve me koncesionarët. Sistemi përfshin menaxhimin e integruar të dokumentave, çështjeve, praktikave, funksioneve administrative dhe marrëdhëniet me subjektet e licensuara në një platformë të vetme. Sistemi mundëson raportimin online të koncesionarëve nga vendodhja e tyre e punës, përpunimin e të dhënave, raportime, analizë të thelluar, etj.

Sistemi është i ngritur mbi platformën RevZone e cila është një sistem i tipit “Service Oriented Architecture” (SOA) dhe bazë të dhënash në MS SQL 2012. Është zhvilluar mbi Microsoft.NET platform, MS SQL Server backend, IIS, Active Directory, services, ASP.NET, aplikacione për windows Desktop dhe forma universale (për përdorim në çdo platformë tjetër).

Platforma është instaluar mbi dy servera: njëri server ka të instaluar databazen MS SQL 2012, kurse serveri tjetër përmban IIS server 8, file server dhe web server. Platforma RevZone funksionale në AKBN përbëhet nga modulet dhe komponentët si më poshtë:

- Case Management
- Business Processes
- Business Intelligence
- Customer Relationship Management (Palët e treta, akses, komunikim i jashtëm)
- Web forms Server (internal modules)
- Web access (external, CRM & HR application modules)
- Integration with other systems

Për Sistemin Revzone të dhëna input janë :

- Të dhënat e deklaruara nga subjektet;
- Të dhënat e punonjësve;
- Dokumentat e krijuara nga punonjësit të cilat qarkullojnë nëpërmjet sistemit, etj.

Për Sistemin Revzone të dhëna output janë: raportet e konsoliduara statistikore të cilat gjenerohen nga raportimet e subjekteve, raportet individuale të subjekteve etj.


Subjekti Zotërues i lejes minerare është i detyruar që brenda afatit 180 ditë, nga data efektive e marrjes së lejes, të fillojë aktivitet minerar duke kryer punime dhe investime në objekt sipas projektit të Miratuar me VKM.

Mbështetur në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar subjekti zotërues i lejes minerare kryhen raportimet përkatësisht:

- Për Raportimin 6 Mujore Kalendarike (6 mujori i I dhe II), sipas shkronjës b, pika 1 të nenit 18 (për mineralet metalorë jometalorë, qymyre dhe bitume) dhe shkronja b, pika 1 të nenit 25 (për mineralet ndërtimor) ku përcaktohet dhe afati për kryerjen e raportimi;
- Për Raportimet Vjetore Kalendarike, sipas shkronjës c, pika 1 të nenit 18 (për mineralet metalorë jometalorë, qymyre dhe bitume) dhe shkronja c, pika 1 të nenit 25 (për mineralet ndërtimor) ku përcaktohet dhe afati për kryerjen e raportimi;
- Aplikim për Miratimin e Programit Vjetor, sipas shkronjës 135 pika 1 të nenit 18 (për mineralet metalorë jometalorë, qymyre dhe bitume) dhe shkronja ç, pika 1 të nenit 25 (për mineralet ndërtimor) ku përcaktohet dhe afati për kryerjen e raportimi;
- Raportim për mbylljen e aktivitetit minerar, sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 37 “zotëruesi i lejes minerare ka detyrim të zbatojë planin përfundimtar të mbylljes së objektit minerar, rehabilitimin e mjedisit për sipërfaqen e prekur nga shfrytëzimi dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, miratuar nga strukturat përgjegjëse”.


Investimi i bërë nga AKBN në këtë program mundëson vetdeklarimet e treguesve të realizuar për çdo subjekt të pajisur me Username dhe Password –in përkatës. User-at e subjekteve fillimisht hapen nga punonjësit në AKBN në bazë të të dhënave që subjekti ka deklaruar, si dhe bëhet njoftimi i tyre për user-in me anë të emailit që kanë deklaruar. Deri në fund të vitit 2023 subjektet të cilët raportojnë online janë loguar në sistemin Revzone nëpërmjet numrit të lejes e cila është e dhënë unike dhe parësore që gjenerohen vetëm nga AKBN, më pas më 01.01.2024 bazuar në strategjinë “Single-Sign-On” të gjithë subjektet loghohen nëpërmjet portalit e-albania me NIPT-in e biznesit ose me ID-in personale të personit i cili përdor sistemin. Gjithashtu në sistem për subjektet minerare është shtuar dhe fusha mbi NIPT-in e subjektit në e-Albania, ku në momentin që subjekti logohet nëpërmjet e-Albania-s e dhëna NIPT/ID do të rregjistrohet me qëllim aksesimin e mëtejshëm nëpërmjet tij në sistem.

Veprime të cilat subjektet i kryejnë nëpërmjet sistemit Revzone:



Automatizimi me anë të sistemit Rervzone i proceseve të veprimtarisë së AKBN-ës në lidhje me Raportimet 6 mujore, Raportim Vjetor, Miratimin e Programit Vjetor është bazuar në workflow-n e mëposhtëm për 3 rastet e raportimit:


Figura nr. 1 Workflow mbi raportimet 6 mujore, raportimin vjetore si dhe miratimin e programit vjetor nëpërmjet sistemit Revzone.



Burimi: AKBN

E njëjta skemë është e konceptuar në sistem dhe për raportimet që bëjnë subjektet, përkatësisht për raportin 6 mujor, raportimin 1 vjetor dhe për miratimin e programit Vjetor.

Sistemi përbëhet nga modulet dhe nën modulet si më poshtë:



Nga auditimi konstatohet se i gjithë procesi i raportimeve për subjektet minerare në sistem ngelet në statusin AKBN (Kontrollon), duke mos bërë dokumentimin si dhe gjurmimin rast pas rasti për secilin raportim që bëhet nëpërmjet sistemit.

Njoftimi i subjekteve në lidhje me konfirmimin e raportimeve që kryejnë në sistemit nuk realizohet nëpërmjet sistemit, ku sispas konfigurimeve teknike të sistemit çdo workflow ka Fillim-->Fund (input->output);

Për të njëjtin subjekt që ka deklaruar raportimin 6 mujor nga viti 2021-2023, raportimet kanë ngelur në statusin AKBN (Kontrollon). Gjithashtu për të njëjtin subjekt për të tre vitet në lidhje me raportimin e Raportit vjetor përsëri rekordi qëndron në stage-in AKBN (Kontrollon). Për të gjitha rastet e konstatuara nga grupi i auditmit procesi ngel në fazën AKBN (Kontrollon) dhe nuk bëhet mbyllje e procesit nga punonjësit e AKBN si dhe një pjesë e tyre nuk ka asnjë koment shpjegues duke sjellë output të pavlefshëm nga sistemi. Nga komunikimet e personat përgjegjës shpjegohet se një pjesë e tyre është ndjekur me rrugë shkreore, ku subjektet të cilët kanë qenë jasht afatit janë lajmeruar me postë, por në sistem nuk rezulton asnjë shpjegim përkatës. Më poshtë paraqiten disa shëmbuj nga sistemi për rastet e sipërcituara:

Current Stage Name	Gjashtemujori	Viti	Progres
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 1	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>

Current Stage Name	Gjashtemujori	Viti	Progres
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>
AKBN (Kontrollon)	Gjashtemujori 2	2023	<div style="width: 50%;"><div style="width: 50%;"></div></div>

Nga auditimi mbi miratimin e planeve vjetore që subjektet duhet të bëjnë nëpërmjet sistemit konstatohet se nuk realizohet/përdoret nëpërmjet sistemit dhe pse është bërë i mundur konfigurimi që ky shërbim të bëhet nëpërmjet tij. Janë të paktat raste kur subjekti bënë vetëm aplikimin në sistem, më pas dokumentacioni meret nga sektori i Procedurave Statistikës, Garancive Financare, Koordinimit dhe GIS të cilët plotësojnë një karteletë ku verifikohen dokumentat që ka dorëzuar subjekti dhe i nisat informacion subjektit në lidhje me datën e daljes në komision. Komisioni i cili ka akses të plotë për të parë dosjet dhe për ti verifikuar dhe për të proceduar me dosjet përkatëse nuk është loguar asnjëherë në sistem me qëllim marrjen e informacionit dhe e gjithë proceduar bëhet me dosje fizike. Gjithashtu konstatohet se për periudhën 2021-2023 jo të gjithë subjektet e kanë bërë raportimin me sistem, si dhe dosjet të cilat kanë ardhë fizikisht me protokoll në AKBN nuk janë hedhur asnjëra në sistem.

Nga auditimi mbi mbylljen e aktivitetit nëpërmjet sistemit konstatohet se për këtë modul që nga implementimi i sistemit dhe deri më tani janë 18 Rekorde nga të cilat 3 prej tyre janë në fazë AKBN (Kontrollon) dhe 15 janë testime. Përgjatë kësaj periudhe ky modul nuk është përdorur dhe pse është bërë i mundur konfigurimi që ky shërbim të bëhet nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi i sistemit konstatohet se subjektet për një raportim sipas udhëzimeve përkatëse mund të plotësojnë disa rekorde dhe ti dërgojnë në fazën AKBN (Kontrollon) pa marrë feedback nga rekordi i parë i plotësuar në sistem. Konstatohet se për disa subjekte ekzistojnë në sistem 2 ose më shumë rekorde për një fazë raportimi.

Nga komunikimet dhe pyetësorët me personat të cilët meren me hedhjen on line në sistem dhe gjenerimin e statistikave, këto raste dalin të gjitha në sistem dhe pse janë të dublikuara për të njëjtin subjekt, specialistët përkatës bëjnë verifikimin me dokumentacionin që mund të jetë dërguar fizikisht me protokoll në AKBN ose ia kthejnë subjektit për modifikim njërin nga rekordet e plotësuar dhe më pas bëjnë hedhjen e saktë të raportimit. Gjithashtu sistemi

gjeneron raport për të gjitha rekordet e hedhura dhe pse një pjesë e tyre mund të ketë të dhëna të pa plotësuara ose të jenë dublikim për të njëjtin subjekt. Të gjitha këto raste kontrollohen dhe modifikohen manualisht nga punonjësit e sektorit të Procedurave Statistikës, Garancive Financiare, Koordinimit dhe GIS me qëllim gjenerimin e raportimeve informative për AKBN dhe MIE.

Nga auditimi u konstatua se:

Në modulën e Hidroenergjetika për nënmodulët si më poshtë:

1. Procesi ndër-institucional për Oponencën Teknike;
2. Procesi OT për vlerësimin e projekt zbatimit;
3. Procesi OT për vlerësimin e studimit të fizibilitetit,

Proceset nuk kanë asnjë rekord të ruajtur, i gjithë procesi i konfiguruar në sistem realizohet fizikisht me anë të shkresave.

Për tre nënmodulët e tjera, konkretisht:

1. HE2- Raport 3 Mujor – Ndërtimi: nga 225 rekorde rreth 35 rekorde janë test dhe pjesa tjetër janë me progres 0%;
2. HE3 – Raport 3 Mujor – Shfrytëzimi: të gjitha proceset janë me progres 0%;
3. HE4 – Raport 3 Mujor – Procedurat: të gjitha janë në proceset me progres 0%.

Nga auditimi u konstatua se Moduli i Rimbursimeve dhe Moduli i Rinovueshmet nuk kanë asnjë rekord në sistem çka do të thotë se nuk janë përdorur asnjëherë nga strukturat përkatëse në AKBN, si dhe moduli AKBN Protokollit ka vetëm rekorde testimi.

Nga auditimi mbi funksionalitetin e sistemit Revzone u konstatua se:

- Konfigurimet e sistemit janë bërë që në vitin 2015, ndonëse gjatë viteve ka pasur ndryshime në veprimtarinë e funksionalitetëve si dhe veprimtarisë së punës nuk janë realizuar konfigurimet/implementimet sipas kryerjeve të proceseve të punës në sistem. Ndryshime ka pasur vetëm në rastin e Drejtorisë së Minierave të cilat lidhen me mënyrën e raportimit të subjekteve me afatin 6 mujor sipas përrcaktimeve të ligjit minerar, si dhe ndryshime të flow-t të modulit të protokollit të brendshëm të sistemit;

- *Nuk disponohet manual* për përdoruesit sipas Drejtorive përkatëse të AKBN të cilët kanë akses në Revzone 1. Minierat, 2. Hidrokarburet, 3. Hidroenergjetika, 4. Rimbursime, 5. Rinovueshmet. Sistemi ka vetëm manualin e administrimit i cili është i hartuar që me konfigurimin e sistemit, si dhe manuali i protokollit të brendshëm i cili është update-uar së fundmi nga sektori i IT dhe Dixhitalizimi i cili momentalisht nuk është miratuar dhe nuk është në përdorim;

- Ka fusha në sistem të cilat janë të pa plotësuara dhe pse konfigurimi i tyre përkatës në sistem rezulton me shenjën “*” që do të thotë se fusha është e detyrueshme për tu plotësuar, konkretisht fusha “Njësia Administrative” e të dhënave të subjekteve minerare;

- Fushat të cilat nuk janë të domosdoshme për tu plotësuar pothuajse në shumicën e rasteve janë lënë bosh;

- Ka raste kur dokumentacioni i ngarkuar në sistem shkarkohet më shumë se një herë për të njëjtin dokument;

- Ekzistojnë rekorde testimi të cilat shfaqen në sistemin live, si dhe opsione në sistem për të cilat nuk dihet funksionaliteti i tyre nga administratori i sistemit, si dhe konstatohen usera të cilët janë larguar nga AKBN dhe janë ende aktiv në sistem

➤ *Nga auditimi mbi aktivitetin e punonjësve të AKBN në sistemin Revzone konstatohet se gjatë periudhës së auditimit për 149 usera aktiv në sistem vetëm 22% e punonjësve e përdorin sistemin, 78% e tyre nuk e kanë aksesuar asnjëherë sistemin.*

Nga auditimi konstatohet se sistemi Revzone nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga AKBN me qëllim administrimin dhe menaxhimin e proceseve të punës në AKBN nëpërmjet këtij sistemi.

Konstatohet se për Drejtorinë e Minerave, sektorët e mbikëqyrjes përkatëse, përkatësisht Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Minerave të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve dhe Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore, asnjë nga shefat e sektorit nuk e kanë aksesuar asnjëherë sistemin kjo në kundërshtim me përshkrimet e punës miratuar me Vendimin nr. 7, datë 20.06.2018 “Për miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në rregulloren e Brendshme të AKBN-së”, ku secili prej shefat e sektorëve bën ballafaqimin e deklarimeve on-line me gjendjen faktike në terren. Specialistët e Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve nuk kanë aksesuar asnjëherë sistemin në kundërshtim me përshkrimet e punës ku sipas përshkrimeve të punës specialisti i parë dhe specialistët kryejnë kontrollin e deklarimeve on-line me gjendjen faktike në terren. Gjithashtu Specialisti i parë i Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore si dhe 4 nga 5 specialistë nuk kanë aksesuar asnjëherë sistemin në kundërshtim me përshkrimet e punës ku sipas përshkrimeve të punës specialisti i parë dhe specialistët kryejnë kontrollin e deklarimeve on-line me gjendjen faktike në terren, duke mos realizuar përshkrimet e punës dhe arritjen e objektivave institucionale.

Nga komunikimet me personat përkatës konstatohet se materialet e subjekteve që janë on line në sistem nuk aksesohen dhe nuk shkarkohen/shikohen nëpërmjet sistemit nga sektorët përkatës të mbikëqyrjes, por shkarkohen/download-ohen nga punonjës të cilët kanë akses në sistem dhe i hidhin në një sharefolder, ku më pas aksesohen nga specialistët e këtyre sektorëve sipas rastit ose printohen dhe dokumentohen fizikisht në dosje përkatëse.

Nga ekstrakti mbi userat e subjekteve minerare në sistem, konstatohet se sistemi Revzone disponon 919 usera, nga të cilët 696 janë aktiv dhe duhet të raportojnë nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi i 919 userave mbi subjektet minerare konstatohet se:

- 94 usera kanë statusin bosh dhe nga këto 94 usera 66 kanë NIPT tek fusha e NIPT për e-albania bosh;
- egzistojnë 57 subjekte për të cilët numri i lejes dhe statusi i lejes është bosh dhe 5 prej të cilëve janë të dubluar
- egzistojnë 9 usera të cilët formati i të dhënave nuk është në të njëjtin standart me userat e tjerë;
- egzistojnë 19 usera të cilëve ju është revokuar leja dhe kanë akoma akses në sistem, ky fakt mbart risk për ndërhyrje të paautorizuara në sistem;
- të dhënat e disa subjekteve janë hedhur ndër vite dhe janë hedhur pa bërë filtrime apo kontrolle në raste dublikimi ose saktësimi, apo verifikimi me të dhënat e mëparshme, duke sjellë dublikime dhe të dhëna jo të sakta në sistem;
- fusha e “Nr Protokollit” në sistem është e plotësuar me “-“ ose me numër 0,00 si dhe data e protokollit duke qenë se është fushë jo e detyrueshme të plotësohet është lënë bosh.

Rastet e sipërcituara lënë hapsirë për mos saktësimin dhe gjurmimin e dokumentacionit justifikues për subjektet e regjistruara në sistem.

Sistemi nuk ka kontrolle për raportimet e subjekteve të cilat janë jashtë afatit ligjor. Afati i raportimeve që bëjnë subjektet nuk ka politikën e kontrollit në sistem për të parë vlefshmërinë e tij, konstatohet se sistemi i lejon subjektet të bëjnë raportimet dhe pse janë jashtë afatit ose para afatit dhe verifikimi për këta subjekte bëhet manualisht pas faktit.

Gjithashtu nisur nga ky fakt nga grupi i auditimit u verifikuan raportimet e subjekteve për vitet 2022 dhe 2023 sipas evidencave statistikore që mbahen nga sektori i Procedurave Statistike, Garancive Financiare, Koordinimit dhe GIS në AKBN.

Nga auditimi konstatohen raste kur subjektet minerare kanë raportuar jashtë afatit në sistem sipas përcaktimeve ligjore për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është aplikuar gjobë sipas legjislacionit në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se sistemi Revzone nuk përmban politika, kontrole që sigurojnë plotësinë dhe saktësinë e input-outputit. Nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi Revzone ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të gabuara, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta;

➤ ***Sistemi i menaxhimit të licensave dhe koncensioneve - GIS***

Sistemi GIS realizon proceset e administrimit dhe menaxhimit të licensave, të drejtave dhe kontratave koncesionare.

Sistemi GIS është i qendëruar, i zhvilluar bazuar në aplikacionin WEB për hedhjen e të dhënave në database me Aplikacione Server, aplikacione Klient dhe Software Klienti. Të dhënat ruhen në Serverin e Databazës.

Sistemi GIS përbëhet nga komponentët:

- Integrimi i Databazës së AKBN dhe Aplikacionit Server;
- Klient GIS software për administrimin e databazës të centralizuar GIS;
- Portali GIS për shikimin e përgjithshëm të të dhënave hapësinore të katër moduleve të AKBN:
 - energjitë e rinovueshme
 - hidrokarburet
 - minierat
 - hidroenergjetika
- Sistemi i kompjuterizuar për administrimin dhe manaxhimin e licensave, të drejtave dhe kontratave koncesionare që konsiston në katër modulet:
 - energjitë e rinovueshme
 - hidrokarburet
 - minierat
 - hidroenergjetiken

Sistemi ka arkitekture klient-server, nëpermet rrjetit lokal kompjuterik. Sistemi GIS të jep mundësinë aktualisht të marrësh të dhëna nga ASIG nëpërmjet shërbimeve WMS nëse është e domosdoshme, *nga auditimi konstatohet se ky funksionalitet nuk është propozuar që të vihet në funksion, nga drejtoritë përkatëse të cilët përdorin këtë sistem.*


Për sistemin GIS të dhënat input janë: të dhënat gjeografike të tipit: shape-file, file autocad, të dhëna tabelore dhe shërbime (psh shërbimet e ofruara nga ASIG).

Për sistemin GIS të dhënat output janë: të gjitha shërbimet e krijuara aktualisht në sistem, të cilat mund të ofrohen për palë të treta bazuar në politikat e institucionit.

AKBN për sistemin GIS disponon 6 licenca të instaluar sipas drejtorive përkatëse.

Për portalin WEB GIS disponohen 7 usera, përkatësisht 2 user-a për drejtorinë Minerare, 2 user-s për Drejtorinë e Hec-eve, 1 user për Drejtorinë e Hidrokarbureve dhe 1 user për Drejtorinë e Energjive të Rinovueshme.

Bllok skemat sesi funksionon sistemi GIS janë si më poshtë:




Burimi: AKBN, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit GIS dhe Portalit WEB GIS u konstatua se:

- Nuk është në përdorim shkëmbimi i informacionit në lidhje me dokumentacionin dhe procedurat me të dhënat në MIE dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar;
- Lidhja me faqen e Portalit WEB GIS nuk realizohet në mënyrë automatike në kohë reale me sistemin GIS pasi konstatohet se punonjësit të cilët kanë akses në sistemin GIS bëjnë hedhjen e të dhënave në mënyrë manuale nga sistemi GIS në Portalin WEB GIS;
- materialet në sistemin GIS nuk janë të përditësuar si dhe egzistojnë koordinata që nuk janë hedhur ose nuk përputhen (rastet e HEC-eve, punonjësit e AKBN referohen në hartat e geoportalit ASIG);
- Portalit GIS ka informacion për publikin vetëm për Drejtorinë e Minierave, ndërsa modulet për Energjinë e Rinovueshme, HEC dhe Hidrokarbure nuk shfaq asnjë të dhënë. Gjithashtu nga verifikimi i kryer në Portalin GIS konstatohet se këto module kanë disa të dhëna të cilat janë hedhur që në implementimin e sistemit, si dhe nuk shfaqen në Portal;
- Portalit GIS ka manual përdorimi vetëm për modulimin minierat;
- nuk disponohet manual për modulet: Energjinë e Rinovueshme, HEC dhe Hidrokarbure, si dhe manual administrimi;

Ndërfaqja e Portali WEB Gis është si më poshtë:



Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se Portali WebGIS i cili është një aplikacion web qëllimi i të cilit është administrimi dhe menaxhimi i licensave, të drejtave dhe kontratave koncesionare për Energjinë e Rinovueshme, Hidrokarbureve, Minierat dhe Hidro-Energjistikën, nuk përdoret nga 3 departamentet përkatëse: Hidrokarburet, Hidro-Energjietën dhe Energjitë e Rinovueshme. Konstatohet se të dhënat për këto departamente janë hedhur rishtazi nga administratori i sistemit që në fillim të implemëntimit të tij dhe aktualisht nuk aksesohen nga publiku duke mos përmbushur objektivat dhe qëllimin e tij.

Nga intervistat me punonjësit e drejtorive përkatëse të cilët përdorin sistemin GIS dhe Web-GIS, konstatohet se vetë punonjësit përdorin mundësi alternative në marrjen e informacioneve nga institucione përgjegjëse si ASIG, programe në autoCAD si dhe harta fizike ekzistuese, kjo për arsye në mungesë të stafit të specializuar për përdorimin dhe përditësimin e GIS dhe Web-Gis. Gjithashtu për Drejtorinë Minerare aktualisht vetëm 1 person përditëson sistemin GIS me të dhënat e lejeve minerare, koordinatat, sipërfaqet, llojin e mineraleve, etj sipas rasteve, pasi specialisti përkatës është pozicion vakant.

Nga auditimi konstatohet se në zbatim të kontratave të mirëmbajtjes që kanë qenë në vazhdimësi për sistemin GIS, konkretisht kontrata nr. 5418 prot., datë 19.10.2020, si dhe kontrata nr. 49 prot., datë 16.02.2023, AKBN nuk ka identifikuar nevojat për trajnim të stafit të cilët punojnë me sistemin GIS dhe Web-Gis dhe pse kjo gjë ofrohet si shërbim nga kontrata në fuqi, pasi numri i punonjësve që punojnë me sistemin GIS dhe WEB GIS është i kufizuar në përdorimin e sistemit. Sipas specifikimeve teknike/Termat e referencës bashkëlidhur kontratës për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit citohet se: *“Suport dhe mirëmbajtje duhet të të ndihmojë përdoruesin të zhvillojë njohuri të mëtejshme mbi ambientin teknik të softëareve, si dhe të asistojë në zgjidhjen e problemeve të pritur ose të papritur që mund të shfaqen gjatë përdorimit të produkteve Esri¹.”* *“Suport dhe mirëmbajtje duhet të të ndihmojë përdoruesin të zhvillojë njohuri të mëtejshme mbi ambientin teknik të aplikimit Web- Gis, si dhe të asistojë në zgjidhjen e problemeve të pritur ose të papritur që mund të shfaqen gjatë përdorimit të aplikimit Web – GIS.”*

- Mbi bazat e të dhënave shtetërore:

Në Vendimin nr. 547, datë 09.08.2006, *“Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”*, i azhurnuar, pika 3, citohet: *“Administron, ekskluzivisht, të gjitha të dhënat*

¹ Sistemi GIS

parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.”

Nga auditimi konstatohet se AKBN për sistemin Revzone që e ka në administrim e cila përmbanë të dhëna parësore dhe të rëndësishme që gjenerohen vetëm nga AKBN, këto të dhëna nuk janë të regjistruara si të dhëna shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përkatësisht në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Sistemi Revzone nuk ka të ngritur Web-service me institucione të tjera nga të cilat merr informacion. Duke qenë në këto kushte sistemi Revzone nuk mund të ndërveprojë me sisteme të tjera (si p.sh. sistemin e QKB-së) që janë klasifikuar si bazë e të dhënave shtetërore në përmbushje me: - Nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore” dhe nenin 9, pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.

- Kodi burim i sistemeve:

Përsa i përket marrjes së kodit burim të sistemeve të implementuara, konstatohet se AKBN për të dy sistemet që disponon nuk ka marrë kodin burim të ndërtimit të sistemeve të implementuara nga operatori i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tyre, në kundërshtim me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrisë për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

Nga auditimi për të dy sistemet u konstatua se:

- nuk disponohet një politikë apo rregullore e dokumentuar dhe miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve për sistemet RevZone dhe GIS, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve etj.
- administratorët e sistemeve dhe detyrat përkatëse nuk janë atribuar me anë të një shkrese zyrtare nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-ës;
- Nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si gjatësia, përmbajtja, përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas praktikave më të mira, standardeve si dhe pikës 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. Sesi i logout nga sistemi nuk është konfiguruar sipas praktikave më të mira pasi user-i qëndron i loguar gjatë gjithë kohës në sistem;

Nga auditimi rezulton se për sistemet që disponon AKBN nuk ka hartuar/miratuar rregullore të përdorimit të tyre, me qëllim adresimin e qartë të proceseve të punës në një sistem të informatizuar. Mungesa e rregulloreve krijon mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar;

- Administrimi i log-eve

Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktivitetëve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Nga auditimi u konstatua se:

- log-et e sistemeve monitorohen manualisht bazuar në kontratën e mirëmbajtjes, por ato nuk janë testuar, analizuar dhe monitoruar ndonjëherë, nëse janë të plota, funksionale dhe të përdorshme. Nuk është e përcaktuar se për sa kohë ruhen këto log-e dhe çfarë procedure ndiqet për analizimin e tyre. Koha e ruajtjes së tyre është e ndryshme rast pas rasti.

- Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, AKBN nuk disponon ndonjë rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e loge-ve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, dhe për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, standardeve të sigurisë si dhe pikës 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT. Rregullorja duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

➤ Në zbatim të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.65/2021, Neni 18 “Detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet” citohet se:

1. Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet ka këto detyrime:

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 6 muaj kalendarikë, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmuajorit përkatës kalendarik, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me detyrimet e lejes së tij minerare dhe planin vjetor;

c) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit kalendarik, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij dhe planin vjetor të punës. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri;

ç) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan vjetor pune, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare, për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes.

Neni 27 “Të drejtat dhe detyrimet e zotëruesit të lejes minerare për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara” në pikën 2, citohet se:

2. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara ka këto detyrime:

a) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo 6 muaj kalendarikë, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmuajorit përkatës kalendarik, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe të gjitha operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor;

b) të paraqesë pranë strukturës përgjegjëse çdo vit, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i vitit përkatës, raportin financiar dhe teknik të të gjitha operacioneve të kryera, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare dhe planin vjetor të punës;

c) të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan pune vjetor, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes.

Me ndryshimin e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.65/2021, detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit

për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, si dhe detyrimet e zotëruesit të lejes së shfrytëzimit me karrierë të mineraleve dhe grupit të mineraleve ndërtimore, sipas pikës b të nenit 18 dhe 27 duhet të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse çdo 6 muaj kalendarikë, jo më vonë se data 15 e muajit që vijon pas gjashtëmujorit përkatës kalendarik, një informacion mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara dhe gjithë operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me detyrimet e lejes së tij minerare dhe planin vjetor. Forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri, përkatësisht, Urdhërit nr. 201, datë 20.06.2021 *“Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore”*, si dhe Urdhërit nr. 202, datë 20.06.2016 *“Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyrit dhe bitumet”*. Në urdhrat përpaktës përcaktohet formati i informacionit, masat administrative në raste mos dorzimit të tyre, si dhe specifikohet se informacioni duhet të dërgohet on line (portali:raport.akbn.gov.al), sipas afateve përkatëse.

Në zbatim të këtij ligji përcaktohet se forma e raportimit përshkruhet në aktet nënligjore që miratohen nga ministri, ku nëpërmjet sistemit Revzone janë bërë konfigurimet përkatëse me qëllim reflektimin e këtyre afateve sipas raportimeve të përcaktuar në ligjin e sipërcituar.

Gjithashtu në të dy urdhrat citohet se: *“Në rast pamundësie për të deklaruar raportimet online, subjektet minerare duhet t'i dorëzojnë ato brenda afateve ligjore, dorazi apo nëpërmjet shërbimeve postare, në AKBN.”*

“AKBN të njoftojë të gjitha subjektet minerare dhe t'i trajtojë mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe raportimeve on-line të informacioneve.”

Nga auditimi konstatohet se urdhrat përkatëse nuk kanë pësuar ndryshime/update-ime në lidhje me raportimet tre mujore, që pas ndryshimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 65/2021.

Gjithashtu nisur nga komunikimet si dhe pyetësorët e zhvilluar në terren me punonjësit e AKBN si dhe konstatimet në sistemin Revzone, një pjesë e konsiderueshme e këtyre raportimeve të subjekteve hidhen nga specialistët përkatës të AKBN, duke qenë se udhërat përkatëse të sipërcituar përcaktojnë se në rast pamundësie subjektet minerare duhet t'i dorëzojnë ato brenda afateve ligjore, dorazi apo nëpërmjet shërbimeve postare, në AKBN.

Nga verifikimi i evidencave statistikore konstatohet se për vitin 2022 janë bërë 24 raportime me protokoll në AKBN dhe për vitin 2023 janë bërë 41 raportime me protokoll në AKBN, ku hedhja në sistem e materialeve është bërë nga punonjësit e AKBN-ës. Gjithashtu konstatohet se pas datës 1 Janar 2024, 148 subjekte ose 16% e tyre nuk kanë raportuar nëpërmjet sistemit.

<p>Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1977/14 prot., datë 02.09.2024 <i>“Mbi Projekt Raportin e KLSH-së me nr. 477/5, datë 29.07.2024”</i>, ku nga shqyrtimi i tyre rezultoi se këto observacione janë të njëjta dhe përsëritje të observacioneve të paraqitura me shkresën nr. 1977/11, datë 18.07.2024 të bëra nga subjekti për Aktkonstatimin nr. 3, datë 10.07.2024, të cilat i kemi shqyrtuar dhe i kemi dhënë përgjigje në Projekt Raport.</p>
--

IV. REKOMANDIME

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në Urdhrin nr. 201, datë 20.06.2021 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore” miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, sot MIE, si dhe në Urdhrin nr. 202, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyrit dhe bitumet”, miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, nuk janë reflektuar ndryshimet në lidhje me raportimet mujore që zotëruesit e lejes minerare duhet të bëjnë, në përputhje me ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 65/2021 neni 18, 27.

Nga auditimi konstatohet se, një pjesë e konsiderueshme e këtyre raportimeve të subjekteve hidhen nga specialistët përkatës të AKBN, duke qenë se urdhrat përkatëse të sipërcituar përcaktojnë se në rast pamundësie subjektet minerare duhet t’i dorëzojnë ato brenda afateve ligjore, dorazi apo nëpërmjet shërbimeve postare, në AKBN, duke sjellë mundësinë e shmangies dhe raportimeve on-line të informacioneve nëpërmjet sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 40-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrin masa për propozimet përkatëse në MIE, me qëllim përditësimin e Urdhrit nr. 201, datë 20.06.2021 dhe Urdhrit nr. 202, datë 20.06.2016, duke pasqyruar ndryshimet në lidhje me detyrimet dhe raportimet që zotëruesit e lejes minerare duhet të kryejnë në përputhje me aktet ligjore në fuqi për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë, si dhe përshtatjen me informatizimet e shërbimeve që kryhen nëpërmjet sistemit.

Brenda vitit 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBN ende nuk e ka përfunduar procesin e kalimit tek AKSHI të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, edhe pse deri në momentin e auditimit kanë kaluar rreth 7 vite nga nisja e procesit të kalimi të asetëve dhe burimeve njerëzore.

Nga auditimi u konstatua se midis AKSHI dhe AKBN nuk është nënshkruar/lidhur një kontratë ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimit që AKSHI i ofron AKBN, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një marrëveshje nivel shërbimi sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi me qëllim monitorimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës. Gjithashtu të marrin masa për përfundimin e procesit të kalimit në AKSHI sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Brenda vitit 2024

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në AKBN, u konstatuan disa problematika si mëposhtme:

- Sistemi i akses kontrolli i cili monitoron hyrjen e personave të autorizuar nuk është i aktivizuar;

- Nuk ka një rregullore/udhëzues të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik;
- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluara nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dysHEME teknologjike e përllogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pënde në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbytje;
- Nuk përbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës;
- Nuk përbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- U konstatua mungesa e kamerave të sigurisë në dhomën e serverëve për monitorimin e hyrje-daljeve dhe veprimtarisë brenda në sallë;
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera (kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, qese, dërrasa, etj) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për përmirësimin e ambienteve të dhomës së serverave përse është konstatuar nga grupi i auditimit, në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim shmangien e shkeljes së sigurisë, humbjes së informacionit, shkatërrim të aseteve dhe mos garantimi i vazhdimësisë së punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se siguria e informacionit në AKBN mbart risqet e larta që vijnë për shkak të sistemeve të operimit apo programet e instaluar në kompjuterat dhe pajisjet PC të AKBN-ës. Në mënyrë të përmblodhur problematikat e konstatuara janë si vijon:

- Pajisjet PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 65%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprerë suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të AKBN-ës vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe;
- Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;
- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc nuk janë të gjitha të licencuara;
- Në këta kompjutera nuk mund të bëhet upgrade në Windows 10/11;
- Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra, por edhe të amortizuara.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se AKBN nuk disponon procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI, sipas praktikave më të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për të përmirësuar dhe standardizuar infrastrukturën IT sipas praktikave më të mira, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje dhe ofrimin e shërbimeve duke marrë në konsideratë dhe zhvillimet teknologjike në AKBN, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së punës dhe funksionimit pa ndërprerje të sistemeve që AKBN disponon. Gjithashtu të marrë masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin,

dokumentimin, trajtimin dhe monitorimin e incidenteve ndaj sigurisë, si dhe dokumentimin e gjithë procesit të menaxhimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBN nuk disponon Politika të Sigurisë së Informacionit dhe një plan strategjik të përshtatshëm si mbështetje për sigurinë e informacionit. Gjithashtu, konstatohet se ndërgjegjshmëria në nivel institucional është e ulët për shkak se nuk janë zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për të gjithë punonjësit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave të Sigurisë së Informacionit dhe në mbështetje të saj të hartojë një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit si hapi fillestar ku bazohen elementët e ndryshëm që i shërbejnë sigurisë, planifikimit dhe zhvillimi të sistemeve, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore aktuale të IT-së, të cilët ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale.

Brenda vitit 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKBN nuk ka hartuar dokumenta të politikave të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronjat c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013. Në këto dokumente përcaktohen masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

Nga auditimi u konstatua se procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një akt administrativ ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e AKBN. Procedura aktuale kryhet nga Operatori Ekonomik dhe ndjekësi i kontratës praktik kjo që përbën risk në humbjen e të dhënave dhe vazhdimësinë në ofrimin e shërbimit.

Nuk janë përcaktuar nivelet e aksesit në të dhënat e backup për sistemet që menaxhohen bazuar në kontratat e lidhura për të cilat AKBN është përfituesi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 datë 31.07.2023 “Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit” të AKSHI-t.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e sistemeve kritike, të dhënat kritike dhe konfidenciale të cilat i akseson në vazhdimësi apo përkohësisht, si dhe përcaktimet e nivelit të aksesit në të dhënat e backup për sistemet. Gjithashtu të hartojë dhe miratojë planet e vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Brenda vitit 2024

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se konfigurimet e Active Directory janë by default dhe nuk janë të konfiguruar në përputhje me praktikat më të mira, duke rritur riskun që ngjarjet e sigurisë të mos parandalohen apo të minimizohen.

Ekzistojnë Njësi Organizative në sistem të cilat janë të krijuara dhe nuk kanë asnjë përdorues; gjenden usera të cilët janë të pa identifikueshëm me emra si Test Test, Test 2, user test, akbn akbn dhe raste të tjera të cilat sjellin risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistemet

dhe në rrjetin e AKBN, si dhe mungon një regjistr log për gjurmimin e problematikave, duke mos lënë gjurmë se cili punonjës ka kryer një veprim të caktuar.

Administratori të dhënave në Active Directory dhe detyrat e tij nuk janë atribuar në asnjë formë nga organet drejtuese të AKBN, sipas funksioneve dhe të gjitha detyrat e administratorit mbi administrimin e bazës së të dhënave të Active Directory.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë për përcaktimin e administratorit të Active Directory dhe detyrave të tij, gjithashtu Sektori i IT-së dhe Dixhitalizimit të marrë masa për analizimin e situatës të evidentuar nga auditimi për konfigurimin e politikave të sigurisë së Active Directory dhe të realizojë konfigurimet përkatëse në përputhje me standardet me të mira, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së aksesit dhe standardizimin e infrastrukturës IT.

Brenda vitit 2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faqes Web (<http://www.akbn.gov.al/>) u konstatua se AKBN nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë (certifikatën e sigurisë) së navigimit online për të rritur sigurinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, AKBN për periudhën objekt auditimi 2021-2023, nuk ka patur plan trajnimi vjetor si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore të Sektorit të IT-ës dhe Dixhitalizimit. Trajnimet e përfituara nga zhvilluesit e sistemeve janë të pa mjaftueshme e nuk plotësojnë nevojat për rritjen e nivelit të njohurive mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit për stafin IT.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 8-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit, si dhe të hartojnë e miratojnë plane trajnimi mbi drejtime specifike të teknologjisë së informacionit. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen tek punonjësit, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit me vlerë të vogël me objekt:

- “Shërbim i internetit për godinat e AKBN, Tiranë dhe Fier (2022)”, për vitin 2022;
- “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s” për vitin 2023, u konstatuan mangësi në:

- Procesverbali i shpalljes së fituesit dhe procesverbali i skualifikimit të operatorëve nuk rezulton të jetë mbajtur nga njësia e prokurimit dhe të jetë bërë pjesë e dosjes;

- Procesverbali për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit nuk është protokolluar nga institucioni;

- Dosjet e procedurës së prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuar”, të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”;

Gjithashtu për procedurën me objekt “Blerje bojë printeri dhe fotokopje për nevojat e AKBN-s”, u konstatuan mangësi në:

- Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

- Procesverbali për skualifikimin e operatorit dhe procesverbali i marrjes në dorëzim nuk është protokolluar nga institucioni;

- Nuk është hartuar një raport përmbledhës në kundërshtim në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar për hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, të marrin masa që për procedurat që do të zhvillohen në vijimësi të përmbushin të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 5301, datë 14.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”, u konstatua se fatura e muajit Shkurt 2021, Tetor 2021, Janar 2022, Korrik 2022 dhe Qershor 2022 janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 5418, datë 19.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje për serverat dhe pajisjet elektronike të dhomës së serverave dhe sistemit GIS”, u konstatua se, disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Janar 2022, Qershor 2022, Korrik 2022, janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës;

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 49, datë 15.02.2023 “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”, u konstatua se disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Gusht 2023 (për periudhën e shërbimit Korrik-Gusht), Nëntor 2023 (për periudhën e shërbimit Tetor-Nëntor), janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.1, të nenit 8 të Kontratës;

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”, u konstatua se disa fatura përkatësisht, fatura e muajit Janar 2022, Qershor 2022, Korrik 2022, Gusht 2022, janë dorëzuar jashtë afatit 30 ditor nga data e lëshimit të faturës tatimore, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pikës 8.3, të nenit 8 të Kontratës;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit që ofrojnë Operatorët e kontraktuar prej AKSHI-t, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në ndjekjen e kontratave të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve të afateve të kontratës sipas kushtet dhe përcaktimeve të Kontratës.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 5301, datë 14.10.2020 me objekt “Mirëmbajtje e sistemit elektronik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore në Republikën e Shqipërisë”, u konstatua se disa fatura dhe raporte mujore nuk janë nënshkruar nga personi ndjekës i kontratës nga AKBN, përkatësisht: fatura dhe raporti i muajit Janar 2021, raporti i muajit Shkurt 2021, raporti dhe fatura e muajit Mars 2021.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 5301, datë 14.10.2020 dhe kontratë nr. 5418, datë 19.10.2020 u konstatua se personat e ngarkuar për ndjekjen e kontratës nuk kanë

hartuar raportin përmbledhës mbi zbatimin e kontratës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 107, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 49, datë 15.02.2023 “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të informacionit për AKBN”, u konstatua se nuk i janë vendosur në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI) Termat e referencës – Specifikimet teknike, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës, të nenit 13 të Kontratës.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site – Disaster Recovery Site”, u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar Draft i raportit përfundimtar nga personat ndjekës të kontratës, kjo në kundërshtim me pikën 6 të Kushteve të Veçanta të Kontratës;

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 44, datë 06.01.2021 “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, u konstatua se:

- Raporti fillestar i Implementimit si dhe procesverbali i dorëzimit të tij nuk është firmosur nga personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës nga AKBN;
- Raporti Final i Implementimit të Projektit nuk është firmosur nga personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës nga AKBN, si dhe një nga anëtarët të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (AKSHI);
- Autoriteti Kontraktor (AKSHI) nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zbatimit të kontratës me operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës;
- personat e ngarkuara për ndjekjen e kontratës nuk kanë hartuar raportin përmbledhës mbi zbatimin e kontratës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 107, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit që ofrojnë Operatorët e kontraktuar prej AKSHI-t, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në ndjekjen e kontratave të marrin masa me qëllim që ndjekja e kontratave të sigurohet në përmbushjen e saj dhe të mos mbetet në kushtet e një procesi formal të realizimit të saj nga ndjekësit e kontratës. Gjithashtu të informojë dhe trajtojë ndjekësit e kontratave për detyrimet ligjore që nevojitet të plotësohen, me qëllim respektimin e akteve ligjore që rregullojnë ndjekjen e kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës për kryerjen e procedurave: “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i procesve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site - Disaster Recovery Site” dhe “Rinovimi i infrastrukturës qendrore të IT (Server, storage, core network) dhe rinovimi i rrjetit të vjetër ekzistues të aksesit IT për përdoruesit e AKBN”, nuk ka kryer përlllogaritjen e vlerës së fondit limit për të dyja procedurat, por janë bazuar në vlerën totale të buxhetit të vitit 2020 të AKBN-ës miratuar nga MIE, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 34, të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për respektimin e kërkesave ligjore e nënligjore në përlllogaritjen e fondit limit për procedurat që do të zhvillojë në drejtim të teknologjisë së informacionit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se i gjithë procesi i raportimeve për subjektet minerare në sistem ngelet në statusin AKBN (Kontrollon), duke mos bërë dokumentimin si dhe gjurmimin rast pas rasti për secilin raportim që bëhet nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi konstatohet se subjektet për një raportim sipas udhëzimeve përkatëse mund të plotësojnë disa rekorde dhe ti dërgojnë në fazën AKBN (Kontrollon) pa marrë feedback nga rekordi i parë i plotësuar në sistem. Konstatohet se për disa subjekte ekzistojnë në sistem 2 ose më shumë rekorde për një fazë raportimi. Sistemi gjeneron raport për të gjitha rekordet e hedhura dhe pse një pjesë e tyre mund të ketë të dhëna të pa plotësuara ose të jenë dublikim për të njëjtin subjekt. Të gjitha këto raste kontrollohen dhe modifikohen manualisht nga punonjësit e sektorit të Procedurave Statistikës, Garancive Financiare, Koordinimit dhe GIS me qëllim gjenerimin e raportimeve informative për AKBN dhe MIE.

Nga analizimi i të dhënave, rezultoi se sistemi Revzone ka mungesë në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna jo të plota, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të pasakta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë rasteve përse është konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim mbylljen e të gjitha proceseve të raportimeve që bëhen nëpërmjet sistemit sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me limitimin e numrit të aplikimeve që krijon subjekti, duke marrë masat e nevojshme për implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit në sistem, për menaxhimin e gabimeve njerëzore dhe teknike në lidhje me përdorimin e sistemit, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara mbi popullimin e të dhënave dhe rritjes së rasteve të dublikuara në sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi miratimin e planeve vjetore që subjektet duhet të bëjnë nëpërmjet sistemit konstatohet se nuk realizohet/përdoret nëpërmjet sistemit dhe pse është bërë i mundur konfigurimi që ky shërbim të bëhet nëpërmjet tij. Komisioni i cili ka akses të plotë për të parë dosjet dhe për ti verifikuar dhe për të proceduar me dosjet përkatëse nuk është loguar asnjëherë në sistem me qëllim marrjen e informacionit dhe e gjithë proceduar bëhet me dosje fizike. Gjithashtu konstatohet se për vitet 2021-2023 jo të gjithë subjektet e kanë bërë raportimin me sistem, si dhe dosjet të cilat janë sjellë fizikisht nga subjektet duke marrë numër protokollit në AKBN nuk janë hedhur asnjëra në sistem.

Nga auditimi mbi mbylljen e aktivitetit nëpërmjet sistemit konstatohet se për këtë modul që nga implementimi i sistemit deri më 10.07.2024 që përkon me mbylljen e fazës së auditimit në terren janë 18 Rekorde nga të cilat 3 prej tyre janë në fazë AKBN (Kontrollon) dhe 15 janë testime. Përgjatë kësaj periudhe ky modul nuk është përdorur dhe pse është bërë i mundur konfigurimi që ky shërbim të bëhet nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi i moduleve të tjera në sistem u konstatua se:

- Në modulën e Hidroenergjetike për nënmodulet si më poshtë:

1. Procesi ndër-institucional për Oponencën Teknike;
2. Procesi OT për vlerësimin e projekt zbatimit;
3. Procesi OT për vlerësimin e studimit të fizibilitetit,

Proceset nuk kanë asnjë rekord të ruajtur, i gjithë procesi i konfiguruar në sistem realizohet fizikisht me anë të shkresave.

Për tre nënmodulet e tjera, konkretisht:

1. HE2- Raport 3 Mujor – Ndërtimi: nga 225 rekorde rreth 35 rekorde janë test dhe pjesa tjetër janë me progres 0%;
2. HE3 – Raport 3 Mujor – Shfrytëzimi: të gjitha proceset janë me progres 0%;
3. HE4 – Raport 3 Mujor – Procedurat: të gjitha janë në proceset me progres 0%.

- Moduli i Rimbursimeve dhe Moduli i Rinovueshmet nuk kanë asnjë rekord në sistem ç'ka do të thotë se nuk janë përdorur asnjëherë nga strukturat përkatëse në AKBN, si dhe moduli AKBN Protokollit ka vetëm rekorde testimi.

Sistemi që nga viti 2015 kur është implementuar dhe deri më 10.07.2024 që përkon me mbylljen e fazës së auditimit në terren nuk ka përbushur qëllimin për të cilin është investuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa të menjëhershme për fillimin e përdorimit dhe popullimin e moduleve ekzistuese të cilat janë implementuar në sistemin Revzone, nga të gjitha strukturat sipas detyrave dhe funksioneve përkatëse, me qëllim automatizimin dhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të cilat është investuar për këtë sistem.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit Revzone u konstatua se:

- Konfigurimet e sistemit janë bërë në vitin 2015, ndonëse gjatë viteve ka pasur ndryshime në veprimtarinë e funksionaliteteve si dhe veprimtarisë së punës, nuk janë realizuar konfigurimet/implementimet sipas kryerjeve të proceseve të punës në sistem. Ndryshime ka pasur vetëm në rastin e Drejtorisë së Minierave të cilat lidhen me mënyrën e raportimit të subjekteve me afatin 6 mujor sipas përcaktimeve të ligjit minerar, si dhe ndryshime të flow-t të modulit të protokollit të brendshëm të sistemit;

- Ka fusha në sistem të cilat janë të pa plotësuar dhe pse konfigurimi i tyre përkatës në sistem rezulton me shenjën “*” që do të thotë se fusha është e detyrueshme për tu plotësuar, konkretisht fusha “Njësia Administrative” e të dhënave të subjekteve minerare;

- Fushat të cilat nuk janë të domosdoshme për tu plotësuar pothuajse në shumicën e rasteve janë lënë bosh;

- Ka raste kur dokumentacioni i ngarkuar në sistem shkarkohet më shumë se një herë për të njëjtin dokument;

- Ekzistojnë rekorde testimi të cilat shfaqen në sistemin live, si dhe opsione në sistem për të cilat nuk dihet funksionaliteti i tyre nga administratori i sistemit, si dhe konstatohen usera të cilët janë larguar nga AKBN dhe janë ende aktiv në sistem.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin, adresimin e parregullsive, përmirësimin dhe rregullimin e problemeve dhe mangësive të konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete për to, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit. Gjithashtu të merren masa për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për ndërtimin e ambienteve test për sistemin, me qëllim testimin e përmirësimeve apo funksionaliteteve të reja mbi sistem pa i aplikuar ato direkt në sistemin live.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se sistemi Revzone nuk është shfrytëzuar dhe nuk është përdorur nga AKBN me qëllim administrimin dhe menaxhimin e proceseve të punës në AKBN nëpërmjet këtij sistemi. Nga auditimi mbi aktivitetin e punonjësve të AKBN në sistemin Revzone konstatohet se gjatë periudhës së auditimit për 149 usera aktiv në sistem vetëm 22% e punonjësve e përdorin sistemin, 78% e tyre nuk e kanë aksesuar asnjëherë sistemin.

Nga auditimi konstatohet se, për Drejtorinë e Minierave, sektorët e mbikëqyrjes përkatëse, përkatësisht Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Minierave të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve dhe Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore, asnjë nga shefat e sektorit nuk e kanë aksesuar asnjëherë sistemin kjo në kundërshtim me përshkrimet e punës miratuar me Vendimin nr. 7, datë 20.06.2018 “Për

miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në rregulloren e Brendshme të AKBN-së”, ku secili prej shefat e sektorëve bën ballafaqimin e deklarimeve on-line me gjendjen faktike në terren. Gjithashtu Specialistët e Sektorit të Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumeve, specialisti i parë i Sektorit të mbikëqyrjes së Shfrytëzimit Racional të Mineraleve Metalore si dhe 4 nga 5 specialistë nuk kanë aksesuar asnjëherë sistemin në kundërshtim me përshkrimet e punës ku sipas përshkrimeve të punës specialisti i parë dhe specialistët kryejnë kontrollin e deklarimeve on-line me gjendjen faktike në terren, duke mos realizuar përshkrimet e punës dhe arritjen e objektivave institucionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa të menjëhershme për fillimin e përdorimit të të gjithë funksionaliteteve dhe shërbimeve online në sistemin Revzone, sipas strukturave dhe detyrave përkatëse të gjithsecilit, me qëllim automatizimin dhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të cilat është investuar për këtë sistem.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga ekstrakti mbi userat e subjekteve minerare në sistem, konstatohet se sistemi Revzone disponon 919 usera, nga të cilët 696 janë aktiv dhe duhet të raportojnë nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi i 919 userave mbi subjektet minerare konstatohet se:

- 94 usera kanë statusin bosh dhe nga këto usera 66 kanë NIPT tek fusha e NIPT për e-albania bosh;
- egzistojnë 57 subjekte për të cilët numri i lejes dhe statusi i lejes është bosh dhe 5 prej të cilëve janë të dubluar;
- egzistojnë 9 usera të cilët formati i të dhënave nuk është në të njëjtin standart me userat e tjerë;
- egzistojnë 19 usera të cilëve ju është revokuar leja dhe kanë akoma akses në sistem, ky fakt mbart risk për ndërhyrje të paautorizuara në sistem;
- të dhënat e disa subjekteve janë hedhur ndër vite dhe janë hedhur pa bërë filtrime apo kontrole në raste dublikimi ose saktësimi, apo verifikimi me të dhënat e mëparshme, duke sjellë dublikime dhe të dhëna jo të sakta në sistem;
- fusha e “Nr Protokollit” në sistem është e plotësuar me “-“ ose me numër 0,00 si dhe data e protokollit duke qenë se është fushë jo e detyrueshme të plotësohet është lënë bosh.

Rastet e sipërcituara lënë hapësire për mos saktësimin dhe gjurmimin e dokumentacionit justifikues për subjektet e regjistruara në sistem.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për analizimin e hollësishëm të të gjithë përdoruesve aktivë për subjektet minerare në sistemet dhe të të gjithë çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesve. Pas analizimit dhe evidentimit të të gjithë përdoruesve, të merren masa për bllokimin e aksesit dhe çaktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët nuk janë të lidhur me përdorues të identifikueshëm, që kanë më shumë se një user, ose përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohen raste kur subjektet minerare kanë raportuar jashtë afateve sipas përcaktimeve ligjore për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë për të cilët nuk është aplikuar gjobë sipas legjislacionit në fuqi. Sistemi nuk ka kontrole për raportimet e subjekteve të cilat janë jashtë afatit ligjor. Afati i raportimeve që bëjnë subjektet nuk ka politikën e kontrollit në sistem për të parë vlefshmërinë e tij, konstatohet se sistemi i lejon subjektet të bëjnë raportimet dhe pse janë jashtë afatit ose para afatit dhe verifikimi për këto subjekte bëhet manualisht pas faktit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: Sektori i IT-së dhe Dixhitalizimit të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për automatizimin e plotë të këtij shërbimi me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit në ofrimin e shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitetin e sistemit GIS dhe Portali WEB GIS u konstatua se:

- Nuk është në përdorim shkëmbimi i informacionit në lidhje me dokumentacionin dhe procedurat me të dhënat në MIE dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar;
- Lidhja me faqen e Portalit WEB GIS nuk realizohet në mënyrë automatike në kohë reale me sistemin GIS pasi konstatohet se punonjësit të cilët kanë akses në sistemin GIS bëjnë hedhjen e të dhënave në mënyrë manuale nga sistemi GIS në Portalin WEB GIS.
- Materialet në sistemin GIS nuk janë të përditësuar si dhe egzistojnë koordinata që nuk janë hedhur ose nuk përputhen (rastet e HEC-eve, punonjësit e AKBN referohen në hartat e geoportalit ASIG);
- Gjatë periudhës së auditimit vetë punonjësit përdorin mundësi alternative të ndryshme si mundësi në marrjen e informacioneve nga institucione përgjegjëse si ASIG, programe në autoCAD si dhe harta fizike ekzistuese, kjo për arsye në mungesë të stafit të specializuar për përdorimin dhe përditësimin e GIS dhe Web-Gis.

Nga auditimi konstatohet se në zbatim të kontratave të mirëmbajtjes që kanë qenë në vazhdimësi për sistemin GIS dhe WEB-GIS, konkretisht kontrata nr. 5418 prot., datë 19.10.2020, si dhe kontrata nr. 49 prot., datë 16.02.2023, AKBN nuk ka identifikuar nevojat për trajnim të stafit të cilët punojnë me sistemin GIS dhe Web-Gis dhe pse kjo gjë ofrohet si shërbim nga kontrata në fuqi, pasi numri i punonjësve që punojnë me sistemin GIS dhe WEB GIS është i kufizuar në përdorimin e sistemit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të marrin masa për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për analizimin, adresimin e parregullsive dhe mangësive të konstatuara nga auditimi në lidhje me përdorimin e sistemit GIS dhe Web GIS dhe të ofrojnë zgjidhje konkrete për to me qëllim sigurimin e kushteve optimale për përdorimin e sistemit sipas qëllimit për të cilin është investuar. Gjithashtu, strukturat drejtuese të AKBN në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit për sistemin GIS dhe WEB GIS mbi funksionalitetin dhe përdorimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Portali WebGIS qëllimi i të cilit është administrimi dhe menaxhimi i licensave, të drejtave dhe kontratave koncesionare për Energjinë e Rinovueshme, Hidrokarbureve, Minierat dhe Hidro-Energjetikën nuk përdoret nga 3 departamentet përkatëse: Hidrokarburet, Hidro-Energjetikën dhe Energjitë e Rinovueshme duke e bërë përdorimin pa efektivitet të sistemit. Konstatohet se të dhënat për këto departamente janë hedhur rishtazi nga administratori i sistemit që në fillim të implementimit të tij dhe aktualisht nuk aksesohen nga publiku/palët e interesit duke mos përmbushur objektivat dhe qëllimin e tij.

Portali GIS ka informacion për publikun vetëm për Drejtorinë e Minierave, ndërsa modulet për Energjinë e Rinovueshme, HEC dhe Hidrokarbure nuk shfaq asnjë të dhënë. Gjithashtu nga verifikimi i kryer në Portalin GIS konstatohet se këto module kanë disa të dhëna të cilat janë hedhur që në implementimin e sistemit, si dhe nuk shfaqen në Portalin WEB.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa të menjëhershme për fillimin e përdorimit dhe popullimin e funksionaliteteve

ekzistuese të cilat janë implementuar në portalin WEB GIS nga të gjitha strukturat sipas detyrave dhe funksioneve përkatëse, si dhe të marrin masa për përmbushjen e qëllimeve për të cilat është investuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se AKBN për sistemin Revzone që e ka në administrim e cila përmbanë të dhëna parësore dhe të rëndësishme që gjenerohen vetëm nga AKBN, këto të dhëna nuk janë të regjistruara si të dhëna shtetërore, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përkatësisht në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Sistemi Revzone nuk ka të ngritur Web-service me institucione të tjera nga të cilat merr informacion. Duke qenë në këto kushte sistemi Revzone nuk mund të ndërveprojnë me sisteme të tjera (si p.sh. sistemin e QKB-së) që janë klasifikuar si bazë e të dhënave shtetërore në përmbushje me nenin 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për “Bazat e të dhënave shtetërore” dhe nenin 9, pika 5 e VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.

Nga auditimi konstatohet se AKBN për të dy sistemet që disponon nuk ka marrë kodin burim të ndërtimit të sistemeve të implementuara nga operatori i cili ka bërë zhvillimin dhe implementimin e tyre, në kundërshtim me rekomandimet e VKM. 710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për Standardizimin e Hartimin e Termave të Referencës për Projektet TIK në Administratën Publike”, të Ministrit për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si dhe “ANEKSIT 1- Termat e Referencës për Projektet TIK” të publikuara nga AKSHI.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marri masa për marrjen e kodit burim për të dyja sistemet që disponon si dhe identifikimin e të dhënave parësore, të dhënat dytësore dhe çdo element që është i nevojshëm me qëllim regjistrimin e bazës së të dhënave shtetërore që AKBN krijon apo disponon dhe të përfundojë procesin e regjistrimit të të dhënave si të dhëna shtetërore sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit Revzone dhe GIS u konstatua se:

- Nuk disponohet një rregullore e dokumentuar dhe miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve për sistemet RevZone dhe GIS, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve etj.
- Nuk janë përcaktuar pozicionet e punës apo punonjësit që nevojitet të kryejnë detyra administrative të sistemeve, Active Directory apo bazave të të dhënave;
- Nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si gjatësia, përmbajtja, përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas praktikave më të mira, standardeve si dhe pikës 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019. Sesioni i logout nga sistemi nuk është konfiguruar sipas praktikave më të mira pasi user-i qëndron i loguar gjatë gjithë kohës në sistem;
- AKBN nuk ka hartuar/miratuar rregullore të përdorimit të tyre, me qëllim adresimin e qartë të proceseve të punës në një sistem të informatizuar. Mungesa e rregulloreve krijon mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar;
- Nuk disponohet manual për përdoruesit sipas Drejtorive përkatëse të AKBN të cilët kanë akses në Revzone për modulet: 1. Minierat, 2. Hidrokarburet, 3. Hidroenergjëtika, 4. Rimbursime, 5. Rinovueshmet.

- Për portali Web GIS nuk disponohet manual për modulet: Energjinë e Rinovueshme, HEC dhe Hidrokarbure, si dhe manual administrimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi: Agjencina Kombëtare e Burimeve Natyrore të marre masa për përcaktimin e administrator-it/ëve të sistemeve dhe infrastrukturës që AKBN disponon, me qëllim përcaktimin e përgjegjësive dhe aksesit që nevojitet të jepet për kryerjen e detyrave administrative në teknologjinë e informacionit. Gjithashtu, AKBN në bashkëpunim me Sektorin e IT-së dhe Dixhitalizimit të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve/manualeve të përdorimit përkatëse për funksionimin e dy sistemeve që ka në përdorim, me qëllim pasqyrimin e saktë të përgjegjësive, detyrave dhe të drejtave për menaxhimin e përdoruesve të këtyre sistemeve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e fjalëkalimeve, ndryshimin e roleve dhe të drejtave të përdoruesve të AKBN dhe subjekteve zotërues të lejeve. Të marrin masa për të dokumentuar dhe aplikuar politikën e sigurisë të implementuara për përdoruesit e këtyre sistemeve, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullore të AKCESK.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Log-et e sistemeve monitorohen manualisht bazuar në kontratën e mirëmbajtjes, por ato nuk janë testuar, analizuar dhe monitoruar ndonjëherë, nëse janë të plota, funksionale dhe të përdorshme. Nuk është e përcaktuar se për sa kohë ruhen këto log-e dhe çfarë procedure ndiqet për analizimin e tyre. Koha e ruajtjes së tyre është e ndryshme rast pas rasti.

- Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, AKBN nuk disponon ndonjë rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e loge-ve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, dhe për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, standardeve të sigurisë si dhe pikës 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT. Rregullorja duhet të specifikojë qartë të gjitha kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 39-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore t'i japin rëndësi sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke filluar me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim analizimin, verifikimin dhe minimizimin e rrezikut në drejtim të sigurisë së të dhënave. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë pajisjet dhe sistemet për të cilat do të ruhen gjurmë elektronike, vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.

Brenda vitit 2024

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës nr. 6963, datë 23.12.2020 “Ngritje e Disaster recovery site dhe automatizimi i proceseve të sigurisë së informacionit dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve midis Primary Site-Disaster Recovery Site”, u konstatua se:

- Vlera e kontratës 52,650,000 lekë (pa TVSH) është 24% më e lartë se fondi që AKBN ka

përlllogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020 në MIE e cila është 40,000,000 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit nuk ka administruar asnjë dokumentacion ndërmjet AKBN dhe AKSHI-it në lidhje me ndryshimin e përlllogaritjes së fondit limit me fondin që AKBN ka përlllogaritur dhe miratuar në Buxhetin e vitit 2020, si dhe nuk është marrë dakordësia nga AKBN për rritjen e fondit limit në vlerën 12,650,000 lekë.

- Nga auditimi konstatohet se AKBN nuk administronte asnjë dokumentacion në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, realizimin e studimit të tregut, përlllogaritjen e vlerës limit dhe hartimin e termave të referencës, për të cilën janë ngritur dhe urdhrat respektiv nga AKBN dhe AKSHI. Dokumentacioni i këtyre shkresave i është vendosur në dispozicion AKBN-ës pas 4 vitesh nga AKSHI, pasi është kërkuar nga grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit nëpërmjet komunikimeve me email dhe shkresave zyrtare drejtuar AKSHI-it nga AKBN.

- AKBN dhe AKSHI nuk kanë dakordësuar me një shkresë zyrtare për hostimin e infrastrukturës së DRS në Datacenterin qeveritar në AKSHI.

- Largësia dhe pozicionimi i site-it DRC sipas nenit 4 të Kushteve të veçanta të kontratës përcaktohet se shërbimet do të kryhen sipas përcaktimeve në ofertën teknik, ku sipas përcaktimeve në ofertën teknike bashkëlidhur kontratës rezulton se vendodhja është përcaktuar përsëri në Datacenterin qeveritar në AKSHI, e cila nuk është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, ku kushtet dhe distanca e ndërtimit të një ambienti dytësor (DRC) duhet të jetë gjithmonë në një pozicion gjeografik që ka risk shumë të ulët që të përfshihet nga i njëjti incident apo fatkeqësi natyrore nga ambienti primar, minimalisht 50 km distancë në vijë ajrore.

- Autoriteti Kontraktor (AKSHI) nuk ka hartuar dhe miratuar planin e zbatimit të kontratës me operatorin ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

- Nga AKBN nuk janë kryer asnjëherë testime për Disaster Recovery Site mbi funksionalitetet e tij në rast se do të ndodhnin evente me pasoja negative (rreziqe natyrore, katastrofa etj) në AKBN, duke sjellë risk të lartë në ndërprerje të shërbimeve dhe kohë të pacaktuar për rikthimin e shërbimeve dhe të dhënave në funksionalitet të plotë.

- Ky shërbim nuk është ofruar nga AKSHI në kundërshtim me kreun II, pika 5, shkronja e), të VKM-ës Nr. 673, datë 22.11.2017, ku sipas Listës nr. 1 “Katalog Shërbimesh”, ndër shërbimet qeveritare është dhe Disaster recovery, “*Ofrimi i një site-i dytësor në strukturën e AKSHI-t në raste fatkeqësish*”.

Përsa më sipër vlera e investimit në shumën 52,650,000 lekë (pa TVSH) që mund të shmangej (të ofrohej nga AKSHI), përbën investim pa efektivitet për institucionin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, në vijimësi të marrin masa mbi organizimin e procedurave të prokurimit ku të analizojnë, argumentojnë dhe dakordësojnë nevojën për përdorimin e tyre për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve në të ardhmen, si dhe të shmangët përcaktimi i fondit limit mbi fondet e planifikuara dhe miratuara në buxhetin e AKBN-ës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT